



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq**

*61*

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**Mbi Auditimin Financiar**

**të ushtruar në**

**BASHKINË FINIQ**

**Tiranë, gusht 2024**

# PËRMBAJTJA

<b>SHKURTIME</b> .....	<b>3</b>
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>4</b>
1. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....	15
<b>II. HYRJE</b> .....	<b>16</b>
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b> .....	<b>21</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Finiq .....	21
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit. ....	22
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. ....	22
2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit .....	27
2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.....	45
2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm .....	57
2.5. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit .....	66
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET</b> .....	<b>70</b>
A. MASA ORGANIZATIVE .....	70
B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR (TË ARDHURA TË MUNGUARA).....	81
C. MASA DISIPLINORE .....	82
<b>V. ANEKSET</b> .....	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Anekset mbi Auditimin e Brendshëm .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Anekset mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Anekset mbi të ardhurat .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Anekset mbi Pasqyrat Financiare .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## SHKURTIME

<b>AAJM</b>	Aktive Afatgjata Jo Materiale
<b>AAM</b>	Aktive Afatgjata Materiale
<b>AK</b>	Autoritet Kontraktor
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
<b>ASHK</b>	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>GMS</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik
<b>IFAC</b>	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
<b>IMTV</b>	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>KKT</b>	Këshilli Kombëtar i Territorit
<b>KPP</b>	Komisioni i Prokurimit Publik
<b>KVO</b>	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
<b>LP</b>	Listëpagesa
<b>LPP</b>	Ligji i Prokurimit Publik
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm
<b>NJP</b>	Njësia e Prokurimit
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues
<b>OE</b>	Operator Ekonomik
<b>PF</b>	Pasqyrat Financiare
<b>QKB</b>	Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonime
<b>ShPK</b>	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
<b>SKK</b>	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>UMFE</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Finiq:

Bashkia e Finiqit kufizohet në veri me Bashkinë Delvinë, në jug me Bashkinë Konispol, në lindje me bashkinë Dropull dhe në perëndim me Bashkinë Sarandë. Kryeqendra e Bashkisë është Finiqi.

Sipas censusit të vitit 2011, numëron një popullsi prej 11,862 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 39,055 banorë në një sipërfaqe prej 441.20 km<sup>2</sup>. Në bazë të të dhënave të censusit, densiteti i popullsisë është 26.7 banorë për km<sup>2</sup>, ndërsa në bazë të regjistrimit civil densiteti është 88.51 banorë/km<sup>2</sup>.

Për vitin 2023, buxheti vjetor është miratuar me VKB nr. 48, datë 29.12.2022 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr 31/1 prot., datë 18.01.2023. Titullari i Bashkisë Finiq, ka paraqitur në Këshillin Bashkiak shkresën e datës 05.12.2022, për miratim të PBA 2022-2024 dhe buxhetin e vitit 2023, e cila është jashtë afateve të parashikuara në dispozitat ligjore. Shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 644,072 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 604,569 mijë lekë ose në masën 94%, sipas artikujve: paga në masën 95.75%, sigurime në masën 91.9%, shpenzime operative në masën 79.1% dhe investime në masën 96.8%. Sipas burimeve të financimit për vitin 2023, nga transferta e pakushtëzuar (granti), treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 167,447 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 143,898 mijë lekë ose në masën 116.36%.

Nga këto investime nga vlera 282,696 mijë lekë planifikuar është realizuar në vlerën 273,717 mijë lekë ose në masën 97%, kjo për shkak se faturat për likuidim janë të muajit dhjetor 2023 dhe janë pasqyruar si detyrime të vitit në mbylljen e pasqyrave financiare.

Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit 2023, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 91,607 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 88,113 mijë lekë ose në masën 96.18%. Nga këto, për pagat është realizuar vlera 36,867 mijë lekë nga vlera 38,710 mijë lekë e planifikuar ose 95.2%, Sigurimet shoqërore nga 7,351 mijë lekë është realizuar në vlerën 6,915 mijë lekë ose në masën 94.06%, shpenzimet operative nga 29,135 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 22,702 mijë lekë ose në masën 77.92% dhe investimet nga 13,911 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 13,898 mijë lekë ose në masën 99.9%.

Për vitin 2023 realizimi i të ardhurave vjetore të planifikuara ka qenë në masën 96.18% lekë.

### b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Bashkia e Finiqit është njësi vendore e pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale përbëhet nga ish komunat Livadhja, Dhivër, Aliko, Finiq dhe Mesopotam, të cilat aktualisht funksionojnë si Njësi Administrative.

Auditimi i këtij institucioni të vetëqeverisjes vendore bëhet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 163 dhe 164, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 10, Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, si dhe Programit të auditimeve për muajin prill 2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 87/3 prot., datë 09.04.2024.

### c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit, janë si vijon:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi;
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;
- Të ndryshme të dala gjatë auditimit

#### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku dhe me përzgjedhje periudhash dhe transaksionesh. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të vlerës së transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe autorizimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Verifikimi i transaksioneve;
- Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
- Intervistat;
- Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.

#### **e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:**

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 15 gjetje dhe ka dhënë 23 rekomandime, nga të cilat masa organizative 14 gjetje me 21 rekomandime dhe masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore (të ardhura të munguara) 1 gjetje me 1 rekomandim.

#### **f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:**

##### ***Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik***

**1.** Nga auditimi u konstatua se komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk funksionojnë dhe nuk kuptohen mjaftueshëm përgjatë gjithë strukturave të njësisë, konkretisht:

- Rregullorja e brendshme e Bashkisë Finiq nuk është hartuar në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi;
- Bashkia Finiq nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit dhe nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve;
- Struktura Organizative e miratuar nuk është e shoqëruar me organigramën përkatëse.
- Bashkia Finiq nuk ka respektuar përcaktimet ligjore për rekrutimin e punonjësve sipas procedurave të konkurrimit dhe në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni. Nuk ka nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil;
- Bashkia Finiq nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, përfshirë vlerësimin e riskut të mashtrimit,
- Në Bashkinë Finiq, Drejtoria Ekonomike dhe e Buxhetit për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program kontabiliteti.
- Bashkia Finiq nuk respekton legjislacionin për trajtimin e kërkesave/ankesave dhe praktikat shpresore, marrëdhëniet me publikun. Vërtetimet e lëshuara përgatiten dhe protokollohen pa u depozituar më parë në protokoll një kërkesë me shkrim nga qytetarët, si dhe nuk kryhet monitorimi i respektimit të afateve për trajtimin e kërkesave dhe ankesave;

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të institucionit në tërësi dhe të njësive të varësisë të tij.
- Mungojnë raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.
- Në Bashkinë Finiq mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.
- Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

**2.** Nga auditimi i veprimtarisë së NjAB për vitin 2023, u konstatua se:

- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.
- Inventarët e dosjeve koherente të auditimit nuk janë në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Formati Standard nr. 1.
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.
- Raportimi mbi aktivitetin vjetor të NjAB, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së miratuar, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;
- Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të NjAB;
- Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, Pika 4.1.12., Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”;
- Në planin vjetor të auditimit, përgjithësisht janë përfshirë për auditim sistemet me risk të mesëm dhe të lartë por nuk është vlerësuar si duhet auditimi i disa fushave me risk, konkretisht nuk janë analizuar dhe nuk është hartuar program i veçantë mbi prokurimet publike.

### ***Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit***

**3.** Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifat vendore që kanë ndaj Bashkisë Finiq, u konstatua se deri në datën 31.12.2022, borxhi tatimor është 213,212,633 lekë. Gjatë vitit 2023 vlera debitore e krijuar është 68,982,140 lekë, në total 282,194,774 lekë, nga të cilat janë kontabilizuar 223,855,848 lekë. **Diferenca prej 58,338,926 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Finiq.**

**4.** Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës në lidhje me respektimin e afatit 30-ditor për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, u konstatua se nuk janë respektuar pagesat për vlerën totale 31,995,678 lekë, nga e cila vlera 25,278,679 lekë janë shpenzime që i përkasin llogarisë 602 dhe vlera 6,716,999 lekë janë shpenzime që i përkasin llogarisë 230/231.

**5.** Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Taksave nuk disponon dokumentacionin përkatës mbi bazën referuese në llogaritjen e detyrimeve sipas llojit të taksës apo tarifës vendore, për çdo subjekt familjar.

Dosjet personale të hapura për çdo biznes kanë mangësi të të dhënave dhe nga vlerësimi i tyre rezultoi se nga 158 subjekte fizike që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Finiq, janë regjistruar pranë QKB dhe disponojnë NIPT 133 subjekte fizike, ndërsa 25 subjekte ushtrojnë aktivitet, paguajnë taksat dhe tarifat vendore, por nuk figurojnë të pajisur me NUIS nga QKB. Gjatë vitit 2023, rezulton se kanë mbyllur aktivitetin 20 subjekte, të cilat figurojnë të çregjistruara në regjistrin e të ardhurave të bashkisë, por nuk disponohet asnjë lloj

dokumentacioni që të faktojë likuidimin e detyrimeve deri në momentin e shkëputjes apo edhe shkresa zyrtare që këto subjekte kanë paraqitur për mbyllje të aktivitetit. Nga vlerësimi i kryer, rezultoi se 4 nga subjektet e mbyllura, pavarësisht mangësive dokumentare në dosjet e subjekteve, figurojnë debitorë pranë Bashkisë Finiq për moslikuidim të taksave dhe tarifave vendore deri në fund të vitit 2022, për vlerën prej 1,757,602 lekë.

Në planifikimin vjetor për biznesin, figuron vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022, si dhe detyrimet e vitit 2023 për të gjitha bizneset, por detyrimi i mbartur në vite nuk figuron i pasqyruar sipas llojit të detyrimit por është i evidentuar në total.

Në regjistrin e bizneseve është përfshirë debia e mbartur, por kjo debi nuk del sipas llojit të detyrimit për çdo zë taksë apo tarifë vendore.

**6.** Nga auditimi u konstatua se struktura e DTTV Bashkia Finiq nuk është plotësisht në funksion të planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. DTTV Bashkia Finiq organizohet në nivel drejtorie dhe ka në përbërjen e saj 2 sektorë. Në strukturën e DTTV mungon “*Spektori i Menaxhimit të Borxhit tatimor*”. Menaxhimi i borxhit tatimor dhe alternimi midis vlerësimit dhe planifikimit është i nevojshëm të organizohet në nivel sektori sepse:

- Këto procese kanë natyrë të ndryshme pune, arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe ka afate të përcaktuara.

- Subjektet debitorë të prapambetur në Bashkinë Finiq kanë peshë si në numër ashtu dhe në vlerë, konkretisht vetëm për kategorinë “Biznes” debitorë të trashëguar nga viti 2022 janë 230 subjekte pra 100% e subjekteve.

- Bashkia Finiq për individët familjarë dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj (sipas kategorizimeve dhe nënkategorive për veprimtarinë që ushtrojnë etj.), ka miratuar në strukturën e paketës fiskale për vitin 2023 në total 65 taksa/tarifa vendore dhe 20 gjoba për kundërvajtje administrative. Struktura e evidencës së realizimit të të ardhurave për vitin 2023 jep informacion mbi planifikimin dhe realizimin vetëm për 18 taksa dhe tarifa vendore.

- Për disa lloje taksash dhe tarifash nuk është përcaktuar qartë struktura e ngarkuar për të bërë përlllogaritjen dhe struktura që do të ndjekë vjeljen e taksës ose tarifës përkatëse. Gjithashtu konstatohet se në disa raste për vjeljen e taksave dhe tarifave të ndryshme ngarkohen njëkohësisht më shumë se dy struktura.

- Procesi për planifikimin, përlllogaritjen e detyrimeve tatimore, ndjekjen e subjekteve debitorë për taksat dhe tarifatat vendore nuk është i saktë, pasi planifikimi për taksat dhe tarifatat vendore nuk është kryer bazuar në rakordimin midis DTTV, DRT dhe QKB për numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin që administron Bashkia Finiq, analizën e rezultatit historik, pritshmëritë e vitit korrent dhe koordinimin midis drejtorive që mbulojnë realizimin e tyre.

- Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj., në regjistrin elektronik në format EXCEL të DTTV-së nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacionin përkatës, duke ndikuar në cilësinë e të dhënave që popullojnë bazën e regjistrit elektronik të DTTV-së, në planifikim dhe në përgatitjen e evidencave të qarta sa i përket identifikimit të subjektit dhe përcaktimit të njoftim detyrimit për t’u paguar lidhur me taksat dhe tarifatat vendore.

- Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2023 nuk jep informacion të plotë mbi të gjitha taksat/tarifatat vendore dhe gjobat e aplikuar për kundërvajtjet administrative pasi drejtoritë që administrojnë taksat/tarifatat vendore nuk mbajnë regjistër për menaxhimin e të dhënave. (Vetëm DTTV administron regjistër për menaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifa vendore).

- Evidenca e realizimit të të ardhurave për vitin 2023 nuk jep informacion për 73% të taksave/tarifave vendore të miratuara në paketën fiskale për vitin 2023, në vlerë absolute 47 taksa/tarifa.

- Në DTTV nuk përcillet informacion lidhur me “Planifikimin” mbi realizimin e pritshëm për taksat/tarifat vendore dhe “Listat e Debitorëve” nga gjithë struktura e ngarkuar për administrimin e të ardhurave, por vetëm nga DTTV për taksat/tarifat që administron. Sa më sipër “Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2023” dhe “Vlerësimi i gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifat vendore” sipas strukturës së Paketës Fiskale të miratuar nuk janë të plota.
- Ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimi apo mbyllja e adresave dytësore dhe të dhënat mbi të cilat përllogariten tarifatat dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese nuk realizohen duke rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.
- Akt konstatimet nga specialistët e terrenit nuk janë të rifreskuara periodikisht (çdo vit) dhe nuk shprehin qartë objektin për të cilin është kërkuar mbajtja e këtij akt konstatimi. Në asnjë rast Akt konstatimet e mbajtura nuk japin informacion të plotë sa i përket:
- Të dhënat e nevojshme për përcaktimin e bazës së taksës nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues të njehsuar me origjinalin (llojit të aktivitetit të deklaruar/faktik nga subjekti, adresën e plotë ku ushtrohet ky aktivitet, sipërfaqen në të cilën ushtrohet aktivitet etj.);
- Mungon gjurma e auditimit mbi vlerësimin e gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifatat vendore.

***Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi***

**7.** Nga auditimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit, u konstatua se procesi i inventarizimit përgjithësisht është kryer nga të njëjtët persona pjesëmarrës në komisionet e viteve të kaluara, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 84.

**8.** Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, është përfshirë vlera 8,030,494 lekë, e cila është e paanalizuar sipas studimeve dhe projekteve. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave të konsoliduara në Bashkinë Finiq.

Në këtë llogari është kontabilizuar edhe vlera 3,369,024 lekë kosto historike, e cila i përket 2 projekteve “Projektim rikonstruksion rruga Dermish-Cerkovicë (viti 2017)” në vlerën 941,623 lekë dhe “Projekt rehabilitimi i kanalit Filipeu”, në vlerën 2,427,401 lekë, të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim. Për pasojë, vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë, por është mbivlerësuar për shumën 3,369,024 lekë.

**9.** Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023, rezultoi se:

- Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione”, është përfshirë vlera 99,236,804 lekë, e paanalizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendjen fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq dhe Livadhja.

- Llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota dhe plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, nuk janë të analizuara në përputhje me kërkesat e përcaktuara në UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku të specifikohet informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

**10.** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2023, rezultoi se:



- Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtim e konstruksione”, është përfshirë vlera 99,236,804 lekë, e paanalizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq dhe Livadhja.

- Llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota dhe plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, nuk janë të analizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku të specifikohet informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

**11.** Nga auditimi, u konstatua se llogaria 231, “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezultoi se për vitin 2023 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat për vlerën 23,056,648 lekë, që i përkasin llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navaricë”, me vlerë të kontraktuar 32,179,880 lekë me TVSh dhe objektit “Rikonstruksioni i rrugës Karroq”, me vlerë 9,999,347 lekë. Gjendja e kësaj llogarie duhet të ishte 42,179,227 lekë.

**12.** Nga auditimi, u konstatua se në analizën e llogarisë 466, “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Finiq, për 19 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Finiq, janë ngurtësuar fonde në vlerën 17,467,104 lekë, për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre dhe për to është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës.

**13.** Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë, u konstatua se është zhvilluar 1 projekt për pritje-përcjellje, për të cilin nuk janë zhvilluar procedurat e prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjin nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën””, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 8, konkretisht me faturën nr. 3, datë 17.06.2023, me objekt “Aktivitet pritje përcjellje për vitin 2023”, me përfitues OE K.T., në vlerën 500,800 lekë, sipas urdhërit të shpenzimit nr. 588, datë 20.12.2023.

#### **Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

**14.** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

Me shkresën nr. 312/11 prot., datë 18.07.2023, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Finiq, sipas Programit të Auditimit nr. 312/1 prot. datë 19.04.2023.

- Bashkia Finiq nuk është shprehur për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të lëna, nuk ka hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, me persona përgjegjës” dhe nuk ka kthyer përgjigje në KLSH brenda 20 ditësh, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja j).

- Bashkia Finiq nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak dhe nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2 dhe Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, “Auditimi i jashtëm”, pika 5.

**a. Nga 26 masa organizative,** janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa, janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk janë zbatuar 14 masa.

**b. Nga 2 masa për shpërblim dëmi,** janë të dyja në proces zbatimi.

**c. Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike,** të dyja masat nuk janë zbatuar.

**d. Nga 7 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara),** 4 masa janë në proces zbatimi dhe 3 masa janë të pazbatuara.

**e. Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Finiq,** për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Kryetarit të Bashkisë Finiq nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e Auditimit të mëparshëm, pra rekomandimi është i pazbatuar.

Nga masat e lëna, pjesë e tyre ishin edhe kërkimi i masave të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 689/7 prot., datë 01.11.2022, konkretisht 10 masa organizative të pazbatuara, 6 masa për mungesë të ardhurash, të cilat janë në proces zbatimi, duke mbetur për arkëtim vlera 182,052 mijë lekë, si dhe 4 masa disiplinore, për të cilat rikërkojmë zbatimin e tyre, ndërsa për masat në proces zbatimi rikërkojmë përshejtimin e zbatimit të tyre.

#### ***Të ndryshme të dala gjatë auditimit***

**15.** Nga auditimi i ankesave të z. F.S., administruar në KLSH me nr. 698 prot., datë 20.05.2024 dhe z. T.E., administruar në KLSH me nr. 730 prot., datë 29.05.2024, u krye verifikimi në Institucionin e Bashkisë Finiq, rezultoi si vijon:

Shtetasi N.V. për të cilin është bërë ankesa, ka ndërtuar një gardh me tela dhe shtylla të vogla të betonuara si dhe ka ndërtuar një portë metalike me dy fletë dhe me kolona të vogla betoni. Për shkak të këtij rrethimi ka pasur ankesa nga banorë të fshatit të cilët pretendojnë se u është bllokuar rruga ekzistuese. Nga IMT dhe Policia Bashkiake Finiq, janë mbajtur disa akte/procesverbale ku janë pasqyruar situatat e konstatuara ndëtimore, si dhe është kërkuar dokumentacioni tekniko-ligjor nga kundërvajtësi. Nga dokumentacioni që administrohej në Bashkinë Finiq, përveç disa akteve/procesverbaleve të mbajtura, nuk disponohet asnjë dokumentacion për punimet e kryera, si dhe nuk disponohet dokumentacion për rrugën e cila është bllokuar. Nga IMT dhe Policia Bashkiake Finiq, pavarësisht mbajtjes së akteve ku konstatohet ndërtimi i gardhit dhe i portës së hekurit, rezulton se nuk janë nxjerrë akte të tjera administrative që lidhen me paligjshmërinë e situatës ndëtimore, duke mos pezulluar veprimet e kundërvajtësit, nxjerrjen e gjobës përkatëse dhe prishjen e ndërtimit.

Lidhur me arsimimin e K/inspektorit të Policisë Bashkiake, ai rezulton pa arsimin përkatës të nevojshëm për këtë pozicion pune.

#### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

#### ***Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik***

**1.** Kryetari i Bashkisë Finiq, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për:

- Hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen dhe vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit;

- Rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrit të Riskut;

- Ngritjen e strukturës së koordinatorit dhe grupit të menaxhimit të riskut;

- Të garantuar se njoftimi/shpallja e vendeve të lira të punës, do të dërgohet zyrtarisht për t'u publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

2. Njësia e Auditimit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Të merren masa për të ngritur Komitetin e Auditimit, me qëllim rritjen e cilësisë të punës audituese.

#### ***Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit***

3. Bashkia Finiq, Drejtorja Ekonomike dhe Buxhetit, Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, në **vlerën totale 282,194,774 lekë**.

4. Me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura, Kryetari i Bashkisë Finiq, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrin masa për likuidimin e faturave për blerje mallrash dhe/ose shërbimesh brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre.

5. Drejtorja e Taksave e Tarifave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masat si vijon:

- Të plotësojë dokumentacionin në dosjet e taksapaguesve familjarë dhe biznese, me qëllim përlllogaritjen e saktë të detyrimeve dhe shmangien e krijimit të të ardhurave të munguara;

- Në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë dhe QKB, të pajisë me NUIS të gjitha subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e saj administrativ. Gjithashtu, të bëjë në mënyrë periodike rakordimet me QKB, me qëllim evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve nga subjektet të cilat mbyllin aktivitetin;

- Me qëllim evidentimin e saktë dhe në vijimësi të detyrimeve të prapambetura, detyrimi i mbartur në vite të pasqyrohet sipas llojit të detyrimit dhe debia e mbartur në regjistrin e bizneseve të dalë sipas llojit të detyrimit për çdo zë takse apo tarife vendore.

6. Drejtorja e Taksave e Tarifave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masat si vijon:

- Të rishikojë dhe saktësojë regjistrin e taksapaguesve kategoria biznes, duke përshtatur kategorinë/nënkategorinë me “veprimtarinë” që ushtrohet, në mënyrë që përlllogaritja e detyrimeve të bëhet e saktë sipas parashikimeve në paketën fiskale. Të rishikohet paketa fiskale duke parashikuar taksa e tarifa për të gjitha kategoritë e biznesit që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë. Të rishikohet “*Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave*” duke parashikuar informacion të plotë mbi të gjitha taksat/tarifave vendore sipas paketës fiskale;

- Të koordinojë punën me institucionet e ndërlidhura, me qëllim marrjen dhe dhënien e informacioneve në kohë reale për shmangien e problematikave të konstatuara;

- Të kryejë inventarizimin e të gjithë subjekteve të cilët janë objekt i taksave vendore, të plotësojë një regjistër me të dhënat përkatëse, të plotësojë dosjet e subjekteve tatimpagues me dokumente justifikuese të cilat shërbejnë për përlllogaritjen e detyrimeve dhe të informojë në mënyrë kronologjike veprimtarinë e tatimpaguesit.

#### ***Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi***

7. Nga Kryetari i Bashkisë Finiq, të merren masa që në komisionet e ngritura për inventarizimin, të mos caktojë dy herë me rradhë të njëjtët persona.

8. Drejtorja Ekonomike Bashkia Finiq, të marrë masa për:

- Analizimin e dokumentacionit për aktivitetet e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, të hyra në vite duke verifikuar, saktësuar dhe analizuar vlerën 8,030,494 lekë dhe të bëjë sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në regjistrin përkatës të aktiveve/inventarin fizik;

- Të sistemojë llogarinë 202 “*Studime e kërkime*”, duke e pakësuar me vlerën 3,369,024 lekë dhe këtë vlerë ta shtojë në vlerën e investimeve të përfunduara.

9. Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masat për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha asetëve të llogarisë 210 “*Toka, troje, Terrene*” dhe llogarisë 211 “*Pyje, Kullota Plantacione*”, përfshirë asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Vlerësimi i asetëve të bëhet për vlerën reale, sipas zonave kadastrale dhe të regjistruhen si pasuri e saj në AShK, dega Sarandë.

10. Drejtoria Ekonomike Bashkia Finiq, të marrë masa për:

- Analizimin e dokumentacionit për aktivet e llogarive 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje, kullota dhe plantacione*”, 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, të hyra në vite duke verifikuar, saktësuar dhe analizuar vlerën dhe të bëjë sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në regjistrin përkatës të aktiveve/inventarin fizik;

- Hartimin e regjistrit të aktiveve të Bashkisë me të gjitha kërkesat e formatit të miratuar, për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

11. Drejtoria Ekonomike, pagesat e vlerave pjesore për blerjen e aktiveve afatgjata, në mbajtjen e kontabilitetit duhet t’i evidentojë në llogaritë 230-231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

12. Kryetari i Bashkisë Finiq, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Kombëtare dhe Administrative të marrin masa për kalimin e fondeve të secili kontraktor për objektin të cilit i ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimit të kryer.

### ***Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm***

13. Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

#### **A.1.1. Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.**

Rekomandimet nr. 1.1, 3.1, 4.1, 6.1, 9.1, 11.1, 11.2, 12.1, 13.1, 14.1, 15.1, 16.1, 17.1, 19.1 dhe 20.1, si dhe masat për rikërimin e zbatimit të rekomandimeve sipas shkresës nr. 689/7 prot, datë 01.11.2022, respektivisht 1.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 25 (masa organizative), 7.1, 9.1, 10.1, 6.1, 28, 5.1, 7.1 (masa për mungesë të ardhurash), që i përkasin kategorive “*masa organizative*” dhe “*mungesë të ardhurash*” të cilat nuk janë zbatuar, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohen, përveç rekomandimeve nr. 7.1, 8.1, 21.1, 22.1, 23.1, 27.1, 28:

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Prokurimit Publik, Bashkia Finiq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i economicitet, efikasë dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit Zhvillim Territorit Bashkia Finiq gjatë dhënies së lejeve të ndërtimit të marrë masa për:

- Respektimin e Planit të Përgjithshëm Vendore dhe Rregulloren Vendore të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.2, datë 10.02.2021.
- Respektimin e lejuar të përdorimi të tokës sipas legjislacionit në fuqi.
- Respektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.
- Respektimin e intensitetit të ndërtimit në zbatim të planit të përgjithshëm vendore.

**21.1. Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq të marrë masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të ekzekutojë vendimet e marra në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Në rast të pamundësisë së vendimeve të prishjes të kërkohet bashkëpunimi me IKMT qarku Vlorë për ekzekutimin e vendimeve të prishjeve.

**22.1. Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq të marrë masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi. Gjithashtu për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi, IVMT të verifikojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit deri në përfundimin e punimeve dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

**23.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa të menjëhershme për vlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kërkesave teknike apo dhe dhënien me qera të sipërfaqeve kullosore.

**27.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Bujqësisë në Bashkinë Finiq të analizojë problemet e konstatuara në lidhje me burimet ujore që disponon bashkia, për të ardhur në ndihmë fermerëve, kjo për evidentimin dhe dokumentimin e sipërfaqeve të mbjella sipas kulturave përkatëse, që u kryhet shërbimi i vaditjes dhe zbatimi i tarifave për çdo shërbim të realizuar, duke kryer monitorimet përkatëse, këto në zbatim të kërkesave të ligjit 24/2017, datë 09/03/2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, Manualit të dërguar nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit në MBZHRAU “Për funksionet e ujitjes dhe kullimit të transferuara të bashkitë”, si dhe paketës fiskale të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë.

**11.1. Rekomandimi:** Bashkia Finiq nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për menaxhimin e aseteve, identifikimin e gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasitet për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë dhe plotësimin e nevojave për komunitetin, por dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre procedura.

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përshpejtimin e zbatimit për ato që janë në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1116/8 datë 01.11.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

**b. Për masa mungesë të ardhurash** janë rekomanduar 6 masa me vlerë 200,267 mijë lekë, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 6 masa, ku nga vlera e rekomanduar prej 200,267 mijë lekë është arkëtuar vlera 18,215 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 182,052 mijë lekë, konkretisht nuk janë zbatuar:

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej 5,300,000 lekë nga 3 subjektet, respektivisht;

- vlera 1,100,000 lekë nga subjekti “T.V.” ShPK
- vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “G.C.G.” ShPK;
- vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “K.” ShPK;
- vlera 2,200,000 lekë nga subjekti “B.O.” ShPK

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 108,000 lekë, respektivisht:

- vlera 54,000 lekë, ndaj subjektit "N."
- vlera 54,000 lekë, ndaj subjekti "E. (A.G.)".

## **B. Masa për shpërbllim dëmi:**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike bashkia Finiq të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 561,540 lekë nga shoqëria "N." shpk, për mos zbatim të kontratës nr. 1736, datë 4.7.2022.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve për menaxhimin e kontratave të analizojë dosjen e procedurës me objekt "Mirëmbajta e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës", për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 68, datë 19.4.2022 (mbi afatin e punimeve), dhe në rast të mungesës së dokumentacionit mbështetës të marrë masa në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Finiq duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 287,831 lekë nga subjekti "A.C." shpk.

## **C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike**

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Finiq, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës ose me subjekte të licencuara për saktësinë e llogaritjes së fondit limit në përputhje me çmimet e manualit për të shmangur mos efektivitetin e fondeve të prokuruar për vlerën 2,290,080 lekë.

## **D. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për bashkërendimin e punës me të gjithë sektorët e tjerë të cilët funksionojnë në planifikimin e të ardhurave, duke përcaktuar qarte vlerat e të ardhurave që duhet planifikuar sipas burimit të krijimit të tyre. Në planifikim buxhetor për vazhdimësinë të pasqyrohen qarte vlera e debisë së mbartur si dhe detyrimi vjetor që është pasqyruar në regjistrin e të ardhurave. Gjithashtu nga ana e Drejtorisë të të ardhurave të Bashkisë të merren masat e menjëhershme për vlerësimin e detyrimeve të subjekteve që merren me tregtinë e hidrokarbureve, duke arkëtuar detyrimin prej 5,600,000 lekë, në rast të kundërt të vlerësohen kërkesat e ligjit deri në pezullimin e aktivitetit.

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Finiq, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2021 në vlerën 213,212,631 lekë.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masat e menjëhershme për auditimin e statusit të këtyre subjekteve në teren, si dhe të kërkohet zbatimi i procedurave për përfitimin e këtij statusi. Po kështu të kërkohet menjëherë arkëtimi i detyrimeve të pa likuiduara nga ana e këtyre subjekteve që është në vlerën 1,757,602 lekë.

**3.1. Rekomandimi:** Njësia e Ujitjes dhe Kullimit pranë Bashkisë Finiq të bëjë monitorimin e gjithë sipërfaqes së mbjellë për çdo kulturë, të monitorojë kërkesat për vaditje dhe të vlerësojë detyrimin sipas kërkesave të ligjit nr. 24/2017, date 09/03/2017 "Mbi administrimin e ujitjes dhe të kullimit".

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq në bashkëpunim me Njësinë e Ujitjes dhe Kullimit, të marrë masa të menjëhershme të bëjë njoftimin të gjithë fermerëve mbi detyrimet

që kanë pa likuiduar për arkëtimin e detyrimeve të mbartura dhe të pa arkëtuara deri në fund të vitit 2022, për vlerën 3,465,443 lekë.

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës së detyrimit prej 3,548,500 lekë nga subjektet përkatës sipas trajtimit analitik të bërë në kapitullin e auditimit të kontratave të lidhura për dhënien me qira të sipërfaqeve kullosore.

#### ***Të ndryshme të dala gjatë auditimit***

**14.** Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit dhe Policia Bashkiake Finiq, të marrin masa për kontroll efektiv të territorit për ndërtimet e paligjshme dhe në çdo rast konstatimi, krahas pasqyrimit me procesverbalet dhe aktet administrative përkatëse, të nxirren edhe masat administrative sipas rastit. Të kërkohet dhe shqyrtohet dokumentacioni i pronës në të cilën kalonte rruga e vjetër, për të cilën pretendohet se është bllokuar.

Lidhur me arsimimin e K/inspektorit të Policisë Bashkiake, Kryetari i Bashkisë Finiq, duhet të ketë në konsideratë faktin se ky pozicion pune ka për detyrim arsimimin policor dhe të marrë masa për rekrutimin e stafit me kualifikimet e nevojshme.

## **1. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit**

### **I. Opinioni mbi Pasqyrat Financiare:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Finiq për vitin ushtrimor 2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, shënimet shpjeguese, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj, duke konkluduar në një **opinion i pamodifikuar, me theksim çështjeje:**

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705 [2], dhe ISSAI 1200 [3], pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “*Theksimi i Çështjes*”. Këto anomali janë të shprehura te baza për opinionin e auditimit.

### **Baza për opinionin e pamodifikuar, me theksim çështjeje:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

### **Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë anomalitë e mëposhtme:**

Në gjykimin profesional të audituesit, krahas riskut cilësor, grupi i punës për vitin 2023 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit 5,073,406 lekë për shpenzimet dhe 6,478,404 lekë për të ardhurat, si dhe anomalitë e mëposhtme:

**1.** Në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*”, është përfshirë vlera 8,030,494 lekë, e cila është e paanalizuar sipas studimeve dhe projekteve. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-

komunave të konsoliduara në Bashkinë Finiq. Në këtë llogari është kontabilizuar edhe vlera 3,369,024 lekë kosto historike, e cila i përket 2 projekteve “*Projektim rikonstruksion rruga Dermish-Cerkovicë (viti 2017)*” në vlerën 941,623 lekë dhe “*Projekt rehabilitimi i kanalit Filipeu*”, në vlerën 2,427,401 lekë, të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim.

2. Llogaria 210, “*Toka, troje, terrene*”, gjatë vitit 2023 nuk ka pasur shtesa apo pakësime dhe gjendja e kësaj llogarie paraqitet e pandryshuar në vlerën 300,000 lekë. Për aktivet që i përkasin kësaj llogarie, për koston historike 300,000 lekë, Bashkia Finiq nuk posedon titull pronësie. Bashkia Finiq nuk ka marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, në total 277 troje objektesh, me sipërfaqe 102,007 m<sup>2</sup>, 127 ngastra toke me sipërfaqe 22,918,856 m<sup>2</sup> dhe 223 ha, si dhe 413 ngastra trojesh, me sipërfaqe 1,048,038 m<sup>2</sup>.

3. Llogaria 211, “*Pyje, kullota, plantacione*”, në datën 01.01.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në këtë llogari nuk janë pasqyruar 855 ngastra, me sipërfaqe totale 15,570,857 m<sup>2</sup> dhe 22,477.4 ha pyje dhe kullota.

4. Në gjendjen e llogarisë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, është përfshirë vlera 99,236,804 lekë, e paanalizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq dhe Livadhja.

5. Llogaria 231, “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezultoi se për vitin 2023 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat për vlerën 23,056,648 lekë, që i përkasin llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, për objektin “*Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navaricë*”, me vlerë të kontraktuar 32,179,880 lekë me TVSh dhe objektit “*Rikonstruksioni i rrugës Karroq*”, me vlerë 9,999,347 lekë. Gjendja e kësaj llogarie duhet të ishte 42,179,227 lekë.

6. Në analizën e llogarisë 466, “*Kreditorë për mjete nën ruajtje*”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Finiq, për 19 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Finiq, janë ngurtësuar fonde në vlerën 17,467,104 lekë, për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre dhe për to është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës.

7. Deri në datën 31.12.2022, borxhi tatimor është 213,212,633 lekë. Gjatë vitit 2023 vlera debitore e krijuar është 68,982,140 lekë, në total 282,194,774 lekë, nga të cilat janë kontabilizuar 223,855,848 lekë. Diferenca prej 58,338,926 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Finiq.

8. Në datën 31.12.2023, vlera e detyrimeve të prapambetura është 28,720,971 lekë. Nga auditimi, rezultoi se krahasuar me vlerën totale të buxhetit të vitit 2023, e cila është 644,072,189 lekë, Bashkia Finiq nuk është në gjendjen e vështirësisë financiare.

## II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 433/1, datë 03.04.2024 “*Auditim Financiar në Bashkinë Finiq*”, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “*Bashkia Finiq*”, nga data 08.04.2024 deri në datën 10.05.2024, u krye “*Auditimi Financiar*”, për periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2023 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P., *Përgjegjës Grupi*;
2. J.G.



### 3. S.H., anëtarë.

**Objekti dhe qëllimi i auditimit:** Objektvii i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Finiq.

**Identifikimi i çështjes:** Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Finiq, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë financiare të Bashkisë Finiq.

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:** Kryetari i Bashkisë, z. R.Ç., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. L.M., Drejtor i Drejtorisë së Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrin ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

**Përgjegjësitë e audituesve:** Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin

dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Finiq, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

**Kriteret e vlerësimit:** Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

**Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhëri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhëri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik“.

**Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:** Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që kanë ndryshuar këtë ligj; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë

29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

**Në fushën e mbajtjes së Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:** VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

**Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:** Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të ZËVENDËSMINISTRIT, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

**Standardet e auditimit:** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve,

Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**Metodat e auditimit:** Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

**Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin<sup>1</sup>:** Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

**Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:**

**Kontrolli aritmetik:** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

**Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:** Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

**Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:** Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

**Kontrolli i vlerësimeve:** Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

**Konfirmimi nga të tretët:** Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

**Kontrolli sipas një treguesi:** Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

**Verifikimi i transaksioneve:** Është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

**Intervistimi:** Është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

---

<sup>1</sup> *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

**Raporte dhe informacione:** Janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

**Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm:** Grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit

**Dokumentimi i auditimit:** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve dhe Akt Verifikimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim për Akt Konstatimet, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 188/5, datë 27.05.2024. Nga ana e Bashkisë Finiq me shkresën nr. 2991/1, datë 28.06.2024, protokolluar në KLSH me nr. 188/6, datë 02.07.2024 është dërguar konfirmimi i marrjes së Projekt Raportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim, nga audituesit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Finiq

##### Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

**Zona Gjeografike:** Bashkia e re e Finiqit kufizohet në veri me Bashkinë Delvinë, në jug me Bashkinë Konispol, në lindje me bashkinë Dropull dhe në perëndim me Bashkinë Sarandë. Kryeqendra e Bashkisë është Finiqi.

**Popullsia:** Sipas censusit të vitit 2011, numëron një popullsi prej 11,862 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 39,055 banorë në një sipërfaqe prej 441.20 km<sup>2</sup>. Në bazë të të dhënave të censusit, densiteti i popullsisë është 26.7 banorë për km<sup>2</sup>, ndërsa në bazë të regjistrat civil densiteti është 88.51 banorë/km<sup>2</sup>.

**Të dhëna të tjera:** Finiqi është një bashki që shtrihet në zonën bujqësore të fushës së Vurgut dhe në zonën malore të rrëzomës së Vurgut. Banorët e zonës i përkasin minoritetit grek dhe kjo zonë ka përjetuar hemorragji demografike si pasojë e largimit të popullsisë drejt kërkimit të një jete më të mirë në Greqi. Zona bujqësore është pjellore dhe aktiviteti bujqësor është rigjallëruar gjatë viteve të fundit.



Infrastruktura e komunës është përmirësuar gjatë dy dekadave të fundit falë investimeve të shumta ndërkufitare por emigrimi ka larguar nga zona pjesën më të madhe të popullsisë, veçanërisht të rinjtë, duke lënë pas njerëz të moshuar.<sup>2</sup>

### **Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat:**

<b>Emri i Njësive</b>	<b>Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre</b>
<b>Livadhja</b>	Fshatrat; Livadhja, Kulluricë, Llazit, Kalcat, Kodër, Lefter Talo, Gravë, Qesarat, Komat, Karroq, Grazhdan, Zminec.
<b>Dhivër</b>	Fshatrat; Dhivër, Rumanxë, Memoraq, Navaricë, Dermish, Leshnicë e Sipërme, Leshnicë e Poshtme, Janicat, Llupsat, Cerkovicë, Shëndre, Malcan.
<b>Aliko</b>	Fshatrat; Aliko, Çaus, Neohor, Tremul, Rahullë, Pllakë, Jermë, Vurgu i Ri, Halo, Dritas.
<b>Finiq</b>	Fshatrat; Finiq, Buronjë, Çlirim, Vrion, Karahaxhë, Bregas.
<b>Mesopotam</b>	Fshatrat; Mesopotam, Dhrovjan, Krongj, Bisticë, Velahovë, Livinë, Brajlat, Sirakat, Kostar, Fitore, Krane, Ardhasovë.

### **Forma dhe mënyra e organizimit:**

Numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 2 datë 02.03.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 279/1 datë 24.03.2023. Struktura Organizative është miratuar me Urdhrin nr. 80, datë 23.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë.

Bashkia Finiq për vitin 2023 ka pasur në strukturë 208 punonjës. Aktualisht, Bashkia Finiq ka gjithsej 197 punonjës, ndër të cilët: 57 Nëpunës Civilë dhe 140 Nëpunës me kontratë sipas Kodit të Punës.

### **Kuadri ligjor:**

Bashkia Finiq është e organizuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Finiq, akte të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Finiq dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

Kryetar i Bashkisë Finiq është z. R.Ç. dhe Këshilli Bashkiak i Finiqit përbëhet nga 22 anëtarë, të cilët janë mandatarë zgjedhjet e datës 28 qershor 2023.

## **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.**

### **2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.**

#### **2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.**

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se:

#### **I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”.**

**Parimi 1:** “Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike”.

Bashkia Finiq organizohet dhe funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të miratuar me Vendimin nr. 60 datë 04.03.2021 të Kryetarit të Bashkisë. Kodi i Etikës është miratuar me Urdhërin nr. 68, datë 11.03.2021 të Kryetarit të Bashkisë.

<sup>2</sup> Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-finiq/pasaporta-e-bashkise-finiq/>

Rregullorja e brendshme e Bashkisë Finiq nuk është hartuar në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, pika 2 dhe neni 9, pika 1.1, gërma “b”, për funksionimin efikas dhe efektiv të veprimtarisë dhe realizimit të funksioneve dhe kompetencave të saj. Ky dokument nuk reflekton përgjegjësitë dhe detyrat për 60% të pozicioneve të strukturës organizative të miratuar për vitin 2023, që përfaqësojnë 58 pozicione pune (108 punonjës), konkretisht: Sekretari i Këshillit Bashkiak 1 pozicion, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike 61 punonjës, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit dhe Arsimit Parashkollor 15 punonjës, Zyra e Gjendjes Civile 5 punonjës, NjA Mesopotam 5 punonjës, NjA Aliko 7 punonjës, NjA Dhivër 5 punonjës dhe NjA Livadhja 9 punonjës.

Nuk është përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit mënyra e rekrutimit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Mungojnë përshkrimet e punës bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Nuk është e përcaktuar mënyra e delegimit të detyrave. Kjo ndikon në cilësinë e shërbimeve publike dhe adresimin e rreziqeve me efikasitet dhe efektshmëri për të gjithë punonjësit e Bashkisë sipas strukturës organizative.

Bashkia Finiq nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit dhe nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve të cilët kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil një herë në 6 muaj ose dy herë në vit, sipas formularit tip. Po ashtu nuk ka vlerësime vjetore për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Finiq me ndryshimet në Rregulloren e Brendshme apo në kuadrin ligjor në fusha të ndryshme.

**Parimi 2.** *“Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.*

Në Bashkinë Finiq, Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura (KLSh, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioneri për të drejtën e Informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale), nëpërmjet raporteve të auditimit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë nëpërmjet vendimmarrjes.

Bashkia Finiq ka paraqitur raport vjetor monitorimi pranë Këshillit Bashkiak sipas tematikës së miratuar në fillim të vitit. Bashkia Finiq ka paraqitur raport vjetor monitorimi në Ministrinë e Financave për realizimin e buxhetit vjetor jo në formë shkresore por me e-mail më datë 26.02.2024.

Nëpërmjet shkresës nr. 231 prot., datë 13.02.2023, është dërguar pranë Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit *“Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.*

Bashkia Finiq nuk disponon raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese lidhur me mangësitë e evidentuara në këtë drejtim. Ky institucion nuk kryen sipas procedurës së miratuar në Rregulloren e Brendshme, hartimin, miratimin, ndjekjen dhe raportimin e brendshëm sa i përket realizimit të planeve mujore. Nga drejtorët e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat.

**Parimi 3.** *“Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.*

Nëpunës Zbatues është caktuar Znj. L.M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, me Urdhërin e Titullarit nr. 127 datë 18.09.2016 *“Për Caktimin e Nëpunësit Zbatues Bashkia Finiq”.*

Nëpunës Autorizues deri në datën 26.06.2023 ka qenë z. K.K., Kryetar i Bashkisë Finiq, i konfirmuar me Vendimin nr. 23-2019-1378 datë 24.07.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Nëpunës Autorizues aktual është z. R.Ç., Kryetar i Bashkisë Finiq nga data 26.06.2023 dhe në vazhdim, i konfirmuar me Vendimin nr. 23-2023-1024 datë 14.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Bashkia Finiq ka hartuar dhe miratuar me VKB nr. 22 datë 20.07.2022 deklaratën e misionit dhe dokumentin e PBA-së. Ky dokument është dërguar pranë MFE më datë 23.07.2022.

Në dokumentet e PBA-ve, janë miratuar strategjitë me objektivat dhe prioritetet strategjike, në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe planveprimin e menaxhimit të financave.

Numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 2 datë 02.03.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 279/1 datë 24.03.2023. Struktura Organizative është miratuar me Urdhërin nr. 80, datë 23.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë.

Realizimi i strukturës për periudhën objekt auditimi është paraqitur në Aneksin MFK1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Struktura e Bashkisë Finiq për vitin 2023 është paraqitur në Aneksin MFK2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Bashkia Finiq për vitin 2023 ka pasur në strukturë 208 punonjës. Përgjatë vitit 2023 janë rekrutuar 20 punonjës të rinj. Janë larguar 18 punonjës .

Gjatë vitit 2023 nuk janë marrë masa disiplinore (*“largim nga shërbimi civil”* për konflikt interesi; *“vërejtje”* për shkelje të rregullave të etikës dhe masa për mbajtje 1/x të pagës).

Bashkia Finiq ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet dhe përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku Bashkia Finiq për vitin 2023 nuk ka procedurë për delegimin e detyrave.

Struktura Organizative e miratuar nuk është e shoqëruar me organigramën përkatëse .

Bashkia Finiq nuk ka respektuar përcaktimet ligjore për rekrutimin e punonjësve sipas procedurave të konkurrimit. Në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni dhe nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe as objektivat për secilin punonjës.

Bashkia Finiq nuk ka të dokumentuara me procesverbal *“Takimet”* e përfaqësuesve të saj me palët e treta, grupet e interesit si dhe dëgjesat me publikun.

**Parimi 4.** *“Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave”.*

Marrëdhëniet e punës në Bashkinë Finiq rregullohen bazuar në Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij.

Punonjësit administrativë dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar.

Titullari i Bashkisë Finiq dhe njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore për vitin 2023 nuk kanë nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil.

Në rastet e largimeve dhe emërimeve në pozicionet drejtuese për vitin 2023 sipas strukturës organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizimin përkatës.

Në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë nuk është ngritur asnjë komision nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është larguar apo marrjen me procesverbal sintetik të dosjeve dhe punës të personelit që kanë filluar ushtrimin e detyrës.

**Parimi 5.** *“Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.*



Me Urdhërin nr. 17 datë 27.1.2022, të Kryetarit të Bashkisë, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik për periudhën 2023-2025, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, gërma “b”, neni 24, pika 2, pjesë e mbledhjeve të këtij grupi është edhe drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

GMS është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave nuk është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

## **2. Komponenti “Menaxhimi i riskut”.**

Bashkia Finiq nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollat që synojnë minimizimin e riskut pra nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues i drejtorive pranë Bashkisë Finiq.

Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e saj në arritjen e objektivave dhe pengojnë marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matrica e riskut” si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III, pika 3.2., “Menaxhimi i riskut”.

## **III. Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”.**

Në Bashkinë Finiq Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program kontabiliteti.

Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.

## **IV. Komponenti “Informimi dhe komunikimi”.**

- Bashkia Finiq nuk respekton rregullat dhe parimet e përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi, sa i përket trajtimit të kërkesave/ankesave, praktikave shkresore, marrëdhëniet me publikun. Në këtë institucion ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura nuk rregjistrohen në një regjistër të sekretuar sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2013 “Për arkivat” dhe rregullores së njëhësuar të punës me dokumentet në autoritet publike të Republikës së Shqipërisë.

Vërtetimet e lëshuara nga ky institucion përgatiten dhe protokollohen pa u depozituar më parë në protokoll një kërkesë me shkrim nga qytetarët për t’u pajisur me këto shërbime si dhe mungojnë formatet standarde të miratuara për aplikim sa i përket llojeve të shërbimeve që ofron ky institucion.

Nuk kryhet monitorimi i respektimit të afateve për trajtimin e kërkesave dhe ankesave dhe mungon një analizë e këtij procesi ku të trajtohen problematikat e konstatuara me të cilat është ndeshur ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve dhe plani i masave për përmirësimin e mëtejshëm të tij.

Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të institucionit në tërësi dhe të njësive të varësisë të tij.

Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit. Njësia publike

përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor, nuk ka sistem IT që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

#### **V. Komponenti “Monitorimi dhe Raportimi”.**

Në Bashkinë Finiq mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Nëpunësi Autorizues, z. K.K. për periudhën 01.01.2023 deri 26.06.2023, Nëpunësi Autorizues, z. R.Ç., për periudhën 26.06.2023 deri 31.12.2023, z. V.X., Sekretar i Përgjithshëm, znj. I.E., Drejtor i Drejtorisë së Personelit dhe Burimeve Njerëzore, znj. L.M., Drejtor i Drejtorisë së Financës, z. E.M., Drejtor i Drejtorisë Juridike, z. S.K., Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

#### **2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.**

Auditimi i Brendshëm në Bashkinë Finiq, është siguruar si shërbim auditimi me Akt Marrëveshjen me nr. 1333 prot., të ofertuesit dhe nr. 2465 prot., të përfituesit, datë 04.10.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 13478/1 prot., datë 31.10.2016, rikonfirmuar me shkresën e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 17390/1 prot., datë 05.11.2021. Akt Marrëveshja për të siguruar këtë shërbim auditimi është lidhur midis titullarëve të Bashkisë Dropull dhe Bashkisë Finiq, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja “c”; Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 64, shkronja “a”; VKM nr. 83, datë 3.2.2016, “Për miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 3 dhe pika 6, shkronja “a”.

Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Finiq është i organizuar me 3 punonjës, 1 drejtues dhe 2 specialistë auditimi, sipas Aneksit AB1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Institucionit, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik dhe Kartën e Auditimit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

Karta e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023, është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 15, datë 13.01.2023 “Për miratimin e kartës së auditimit të brendshëm”, dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1916/1 prot datë 13.10.2023.

Plani strategjik si dhe plani vjetor për vitin 2023, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të seksionit 3, kreu II të “Manualit për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe të nenit 14, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të cilat janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë Finiq, me shkresën nr. 2803 prot, datë 19.10.2022, si dhe i janë dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1773 prot, datë 19.10.2022. Plani vjetor i auditimit si një dokument bazë i veprimtarisë audituese, parashtron kriteret e procedura të cilat janë parashikuar në dispozita ligjore si, fushat prioritare, frekuencën e auditimeve, përmirësimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve dhe nevojave për auditim, koston e auditimit, etj..

Raporti Vjetor i veprimtarisë, së bashku me pasqyrat përkatëse dhe pyetëtorin e vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm, është miratuar nga Titullari dhe është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 231 prot,

datë 13.02.2024, konform kërkesave të nenit 14, pika ‘ç’ të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

### **2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm.**

Struktura e Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare të Auditimit për vitin 2023 është plotësuar sipas standardeve të vendosura në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, Pika 4.1.12., Hapi 11.

Dosjet koherente të NjAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi, në përgjithësi janë mbajtur të plotësuara, bazuar në kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, në to është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme. NjAB për vitin 2023 ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Plani Vjetor për auditimet të cilat do të realizohen nga NJAB për vitin 2023, është miratuar me shkresën nr. 4069/1 prot., datë 11.10.2022 dhe objekt auditimi kanë qënë subjektet si më poshtë:

1. Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që janë lënë në auditimet e mëparshme, nga audituesit e brendshëm.
2. Vlerësimi i situatës mbi detyrimet e prapambetura.
3. Vlerësimi i sistemit “Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Administrimi i ujrave, pyjeve, livadheve dhe kullotave. Vlerësimi i shërbimit urban dhe shërbimeve publike. Funksionimi i policisë bashkiake”.
4. Vlerësimi i funksionimit të Njesisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Programet përgjithësisht kanë përmbledhur orientimet kryesore dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

Për vitin 2023, planifikimi vjetor është realizuar 100%, pra janë realizuar 4 auditime nga 4 që janë planifikuar për t’u kryer.

Në lidhje me rekomandimet e lëna pas përfundimit të “*Auditimit të përputhshmërisë*”, të realizuar për veprimtarinë deri në fund të vitit 2022, dërguar Raporti Final me shkresën nr. 2285/2, datë 11.10.2022, janë lënë gjithsej 2 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 2 rekomandime. Deri sot nuk është hartuar plani i veprimit.

Janë dhënë dhe pranuar 2 rekomandime të karakterit organizative, nga të cilat nuk është zbatuar 1 rekomandim.

Pasqyra e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e realizuara nga NJAB për vitin 2023 dhe faza e zbatueshmërisë së tyre është paraqitur në Aneksin AB2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për aktivitetin e vitit 2023 është hartuar raporti dhe i është përcjellë brenda afatit Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm në MFE, me shkresën nr. 231 prot. datë 13.02.2024, bashkëlidhur dokumentacioni si më poshtë:

- Raporti i veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023,
- Pasqyrat përkatëse të raportit vjetor 2023,
- Pyetëtori i vetëvlerësimit të auditimit të brendshëm për vitin 2023,

## **2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

### **2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.**

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA-së për vitet 2023-2025, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, konkretisht është ngritur grupi i punës, janë marrë kërkesat për nevojat për punë, mallra e shërbime, është bërë llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta,

përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se në njësinë e vetëqeverisjes vendore janë kryer konsultime me grupet e interesit.

Me shkresën nr. 3287/1 prot., datë 27.12.2022, dhe në bazë të Urdhërit nr. 7 prot., datë 27.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë z. K.K., është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) i përbërë nga 9 anëtarë si dhe ekipet e menaxhimit të programeve, të përbërë nga 16 anëtarë sipas njërive shpenzuese buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2023-2025.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ujësjellës kanalizime etj., gjë e cila vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktik të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritetet.

Për vitin 2023, titullari i Bashkisë Finiq në përputhje me kriteret dhe kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *“Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”*, Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, etj., ka paraqitur në Këshillin Bashkiak shkresën e datës 29.12.2022, për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe buxhetin e vitit 2023, por jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”*, neni 41, *“Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”*, pika 1.

VKB nr. 48, datë 29.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 31/1 prot., datë 18.01.2023 është bazuar në projektvendimin dhe relacionin e hartuar nga Drejtoria e Financës, znj. L.M. dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. K.K..

Në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjegues, si për fazën e parë dhe për fazën e dytë të PBA 2023-2025, sipas VKB nr. 43, datë 27.10.2023. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2023-2025, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 12 programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA për vitet 2023-2025 janë përcaktuar *“Përshkrimi”* i çdo program, *“Politika e programit”*, *“Qëllimi i Politikës së programit”* dhe *“Objektivat e politikës së programit”*. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuara produktet e programeve buxhetore, në të gjitha fazat e përgatitjes së tij.

Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve, është paraqitur në Aneksin B1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Dokumenti i programimit të buxhetit vjetor për vitin 2023, i miratuar me VKB nr. 48, datë 29.12.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 31/1 prot, datë 18.01.2023, përfshin transfertën e pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE dhe korrespondencën zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë vitit 2023.

Programimi i shpenzimeve për vitin 2023 i detajuar sipas programeve, është paraqitur në Aneksin B2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Ndarja e shpenzimeve sipas natyrës për viti 2023, është paraqitur në Aneksin B3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku konstatohet se pjesa dërmuese e fondeve, rreth 45.2% shkon për zërin investime.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “fondin e pagave” dhe “sigurimet shoqërore” (600, 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për Shpenzime të tjera korrente (602-609), është bërë bazuar në kërkesat e sektorëve të këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimit të pritshëm.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “investime” (230-231), është bërë duke mbajtur në konsideratë tendencën e realizimit të të ardhurave të veta, grantin dhe fondet që vijnë nga buxheti i shtetit.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Finiq për vitin 2023, janë paraqitur në Aneksin B4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit,

Për vitin 2023, për artikullin “*Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës*” është planifikuar vlera 3,714 mijë lekë osë në masën 0.57%, për artikullin “*Transferta e pakushtëzuar, trashëguar viti paraardhës*”, është planifikuar vlera 6,094 mijë lekë osë në masën 0.04%, për artikullin “*Trashëguar nga transfera specifike*”, është planifikuar vlera 24,911 mijë lekë ose në masën 10.75%, për artikullin “*Plani i të ardhurave për vitin ushtrimor*”, është planifikuar vlera 91,607 mijë lekë ose në masën 11.3%, për artikullin “*Granti*”, është planifikuar vlera 167,445 mijë lekë ose në masën 21% dhe për artikullin “*Transferta specifike*”, është planifikuar vlera 62,401 mijë lekë ose në masën 8.2%.

Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, detyrimet kreditore sipas pasqyrave financiare në datën 31.12.2023, janë në shumën totale 48,222,357 lekë ose 43.26% e buxhetit fillestar. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023 rezulton se jo e gjithë shuma është programuar për likuidim.

Në datën 31.12.2023, vlera e detyrimeve të prapambetura është 28,720,971 lekë. Nga uditimi, rezultoi se krahasuar me vlerën totale të buxhetit të vitit 2023, e cila është 644,072,189 lekë, Bashkia Finiq nuk është në gjendjen e vështirësisë financiare.

Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, në vlerën 41,559,983 lekë.

Llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari lidhura me to*”, në vlerën 6,662,374 lekë.

Vlera e parashikuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura është paraqitur në Aneksin B5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga Bashkia Finiq në buxhetin vjetor janë parashikuar fonde në vlerën 27,868,956 lekë, me një diferencë më pak planifikimi për likuidim në vlerën 20,353,404 lekë, krahasuar me detyrimet më datë 31.12.2022, të cilat janë në vlerën 48,222,360 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 2, datë 06.02.2012, “*Për procedurat standarde të zhvillimit të buxhetit*”, neni 101.

Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, është paraqitur në Aneksin B6 dhe B6/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### ***2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.***

Për vitin 2023, ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të granteve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për shtesën e pagave për transfertën e pakushtëzuar, funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, shpërblime, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Këto ndryshime janë kryer, sipas Vendimeve të Këshillit të Bashkisë dhe me shtesa të fondeve të kushtëzuara në Thesar sipas Aneksit B7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Me VKB nr. 1, datë 02.03.2023, është realizuar shprehëdarja e të ardhurave të trashëguara në vlerën 34,719 mijë lekë. Me VKB nr. 22, datë 21.07.2023, është miratuar shtesë buxheti në vlerën 13,449 mijë lekë për emergjencat civile dhe shtesat për pagat në të gjitha programet për arsimin, në vlerën 415 mijë lekë shtesë për aparatën dhe shërbimet, në vlerën 6,106 mijë lekë shtesë për pyjet e kullotat, 240 mijë lekë shtesë fondi për pagat e Mzsh, ujitja, kullimi etj. Shtesë fondi për emergjencat civile në vlerën 2,900 mijë lekë. Gjithashtu, në vitin 2023 në bushtetin e Bashkisë Finiq janë shtuar edhe 3,500 mijë lekë nga Qarku, për investimin “Rikonstruksion i rrugës Vagalat-Karroq”. Po ashtu në vitin 2023 u shtua fondi për transfertën e pakushtëzuar me vlerën 17.441 mijë lekë, të cilat janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve, vlera me të cilën është rakorduar me degën e Thesarit në fund të vitit 2023 për buxhetin përfundimtar të planifikuar, nga 371,782 mijë lekë që ka qenë buxheti fillestar, në fund të vitit është bërë 644,072 mijë lekë. (ndihma ekonomike në vlerën 92,121 mijë lekë dhe gjendja civile në vlerën 4,575 +2,303 mijë lekë për pagesën e komisioneve zgjedhore).

### ***2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.***

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq ka rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Delvinë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Delvinë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak ose të diktuar nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli rezulton se përgjithësisht është respektuar disiplina buxhetore sipas Aneksit B8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sa më sipër, për vitin 2023 shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 644,072 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 604,569 mijë lekë ose në masën 94%, sipas artikujve: paga në masën 95.75%, sigurime në masën 91.9%, shpenzime operative në masën 79.1% dhe investime në masën 96.8%. Sipas burimeve të financimit për vitin 2023, nga transferta e pakushtëzuar (granti), treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 167,447 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 143,898 mijë lekë ose në masën 116.36%.

Nga këto investime nga vlera 282,696 mijë lekë planifikuar është realizuar në vlerën 273,717 mijë lekë ose në masën 97%, kjo për shkak se faturat për likuidim janë të muajit dhjetor 2023 dhe janë pasqyruar si detyrime të vitit në mbylljen e pasqyrave financiare.

Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit 2023, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 91,607 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 88,113 mijë lekë ose në masën 96.18%. Nga këto, për pagat është realizuar vlera 36,867 mijë lekë nga vlera 38,710 mijë lekë e planifikuar ose 95.2%, Sigurimet shoqërore nga 7,351 mijë lekë është realizuar në vlerën 6,915 mijë lekë ose në masën 94.06%, shpenzimet operative nga 29,135 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 22,702 mijë lekë ose në masën 77.92% dhe investimet nga 13,911 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 13,898 mijë lekë ose në masën 99.9%.

Për vitin 2023 realizimi i të ardhurave vjetore të planifikuara ka qenë në masën 96.18% lekë. Pra planifikimi i shpenzimeve buxhetore është real dhe i mbështetur në burime të sakta financimi për të ardhurat e veta.

Realizmi i të ardhurave dhe përdorimi i tyre:

Realizimi i të ardhurave dhe përdorimi i tyre për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, sipas aktrakordimeve me Degën e Thesarit Delvinë, si dhe analiza e detajuar për të ardhurat e vitit 2023, janë paraqitur në Aneksin B9 dhe B9/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në planifikimin e shpenzimeve janë marrë në konsideratë pjesërisht faturat e palikuiduara të vitit paraardhës të cilat janë në vlerën 48,222 mijë lekë, nga e cila në buxhetin e vitit 2023 është planifikuar vlera 27,868 mijë lekë ose 57,79% e totalit, të dhëna sipas Aneksit B10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10, datë 27.02.2020, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2023”, i ndryshuar, UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 87,213 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 80,298 mijë lekë ose në masën 92.07%. Nga këto investime janë realizuar 20,400 mijë lekë ose në masën 100% .

Nga fondet e deleguara, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 78,240 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 188,113 mijë lekë ose në masën 240%.

Sa më sipër, u konstatua se nuk ka diferencë të dukshme midis treguesve të planifikimit buxhetor në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara në vitin 2023 ka një realizim të të ardhurave në masën 97%, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, sipas Aneksit B11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sipas planifikimit dhe realizimit në buxhet për vitin 2023, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore gjithsej nga 91,607 mijë lekë në buxhetin fillestar, janë çelur në thesar sipas realizimit faktik dhe ato të trashëguara në vlerën 88,113 mijë lekë ose 97%, me një mosrealizim në vlerën 3,494 mijë lekë.

Miratimi i buxhetit faktik për vitin 2023 është me VKB nr. 1, datë 02.03.2024, miratuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 279/1 prot., datë 24.03.2024.

#### **2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.**

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës në lidhje me respektimin e afatit 30-ditor për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, u konstatua se nuk janë respektuar pagesat për vlerën totale 31,995,678 lekë, nga e cila 25,278,679 lekë janë shpenzime që i përkasin llogarisë 602 dhe 6,716,999 lekë janë shpenzime që i përkasin llogarisë 230/231.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar dhe UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar.

Të dhënat e detajuara janë paraqitur në Aneksin B12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sasia e faturave të palikuiduara në vlerën e plotë ose të likuiduara pjesërisht, është paraqitur në Aneksin B13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Planifikimi i detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetin respektiv, është paraqitur në Aneksin B14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në shumën e paplanifikuar përfshihen dhe vendimet gjyqësore dhe detyrimet që rrjedhin nga energjia elektrike, të mbartura ndër vite.

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “*Detyrimet e prapambetura*”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura janë paraqitur në Aneksin B15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shuma e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2023, është 28,720,971 lekë.

#### Mbi vendimet gjyqësore:

Gjatë periudhës ushtrimore 2023, nuk ka pasur shtesa detyrimesh nga vendimet gjyqësore. Në total janë 122,400 lekë, e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkisë Finiq.

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të MFE rubrika “*Detyrimet e prapambetura*” sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura janë paraqitur në Aneksin B16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Raportet e Monitorimit:

Për vitin 2023, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit dhe realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre nëpërmjet e-maileve përkatëse.

#### Investimet dhe planifikimi/realizimi i prokurimeve:

Financimet e kontratave për investime, burimet e financimit si dhe likuidimet sipas viteve janë paraqitur në Aneksin B17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vlera e kontratave të pambyllura ndërvite dhe të palikuiduara deri më 31.12.2023, është paraqitur në Aneksin B18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Bashkinë Finiq, është paraqitur në Aneksin B19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Parashikimi buxhetor për realizimin e procedurave të prokurimit për vitin 2023, në artikullin (602/231) është në vlerën 81,412,368 lekë si më poshtë:

Prokurimeve me vlera të larta në vlerën 68,186,002 lekë.

Prokurime me vlera të vogla në vlerën 13,676,366 lekë.

Nga prokurimet me vlera të larta është parashikuar në fushën e investimeve vlera 34,647,168 lekë dhe në fushën e shërbimeve/blerjeve, vlera 46,765,200 lekë.

Vlera e parashikuar për realizimin e procedurave të prokurimit për vitin 2023, në artikullin (602/231) është në vlerën 55,094,544 lekë si më poshtë:

Prokurimeve me vlera të larta 47,597,526 lekë.

Prokurime me vlera të vogla 7,497,018 lekë.

Prokurimet me vlera të larta janë realizuar në fushën e investimeve 21,247,296 lekë dhe në fushën e shërbimeve/blerjeve 33,847,248 lekë.

Vlera e fondeve të palikuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2023, për artikullin (602/231) ka qenë 2,455,869 lekë si më poshtë:

Prokurimeve me vlera të larta 1,690,269 lekë.

Prokurime me vlera të vogla 765,600 lekë.

Në fushën e investimeve janë realizuar prokurimet me vlera të larta në vlerën 19,557,027 lekë, dhe në fushën e shërbimeve/blerjeve në vlerën 33,081,648 lekë.

Regjistrat e planifikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit për vitin 2023, janë paraqitur në Aneksin B20 dhe B21, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për veprimet dhe dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi c. R.Ç., me detyrë Kryetar i Bashkisë Finiq dhe në cilësinë e Nëpunës Autorizues znj. L.M., me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

**2.2.5. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të asetëve.**



*Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.*

**Burimi i krijimit të të ardhurave:**

Për vitin 2023 burimet e financimit të Bashkisë Finiq, ndahen në 3 kategori: të ardhurat nga burimet e veta, transferata nga Buxheti Qëndror dhe trashëgimi nga viti i shkuar, trajtuar si më poshtë vijon:

Të ardhura nga burimet e veta (zënë 14.2% të të ardhurave të përgjithshme).

Sipas informacionit në evidencën e të ardhurave (rakorduar me thesarin) marrë nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike, rezulton se:

- Planifikimi për vitin 2023 është 91,607,000 lekë;

- Realizimi faktik për vitin 2023 është 88,113,344 lekë;

(Realizimi faktik ka qenë 91,613,344 lekë, nga të cilat 3,500,000 lekë janë fonde të transferuara nga Këshilli i Qarkut Vlorë dhe 223,000 lekë taksat e pullave.

Realizimi faktik i vitit 2023 krahasuar me vitin 2022, në përqindje është +22% ose në vlerë absolute është 16,343,344 lekë më shumë.

- Transfertat nga buxheti qëndror zënë 80.4% të të ardhurave të përgjithshme;

- Trashëgimi nga viti i shkuar zë 5.4% të të ardhurave të përgjithshme.

Për vitin 2023 Bashkia Finiq një pjesë të nevojave për financim e ka mbuluar nga të ardhurat e trashëguara. Nga auditimi u konstatua se nuk ka evidenca të plota për llojin e të ardhurave të trashëguara “*Të ardhura nga burimet e veta*”, të cilat do të shërbejnë si bazë për destinimin e tyre në shpenzime (procesin e buxhetimit). Kjo e bën të pamundur verifikimin e burimit nga është krijuar kjo e ardhur dhe si pasojë nuk jep mundësinë për të kontrolluar mënyrën e përdorimit të tyre.

**Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:**

Veprimtaria e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV Bashkia Finiq), mbështetet në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, organizohet sipas Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për këtë qëllim.

Për vitin 2023 me VKB nr. 2, datë 02.03.2023 është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 279/1 prot., datë 24.03.2023. Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 80 datë 23.02.2023, është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/vektorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë edhe Drejtoria e të Ardhurave, e cila ka në përbërje 11 punonjës, të ndarë në dy sektorë:

- Sektori i kontabilizimit dhe shërbimit ndaj taksapaguesve, 5 punonjës;

- Sektori i Inspektoratit tatimor dhe kundërvajtjeve administrative, menaxhimi i debitit, konfiskimi dhe sekuestrimi, 6 punonjës.

Për vitin 2023 me VKB nr. 47 datë 29.12.2022 “*Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023*”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 31/1 prot., datë 18.01.2023.

Strukturat për mbledhjen e të ardhurave në territorin që administron kjo Bashki janë: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Bujqësisë, Ujitje Kullimi, Drejtoria e Pyje dhe Kullotave, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra e Protokoll-Arkivit, Policia Bashkiake.

DTTV Bashkia Finiq raporton tek titullarët për rakordimin mbi planifikimin dhe realizimin e gjithë strukturës së taksave/tarifave të paketës fiskale edhe pse sipas përcaktimeve në paketën fiskale të Bashkisë Finiq administron vetëm 13 taksa/tarifa vendore.

**Mbi përputhshmërinë e strukturës së taksave/tarifave vendore në paketën fiskale me evidencat që përdoren për planifikim realizim dhe raportim.**

Gjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, miratuar me VKB nr.47 datë 29.12.2022

“Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023”, e cila nuk ka pësuar ndryshime derit në fund të vitit 2023.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2023, kryesisht në ndarjen e detyrave, mbi strukturën që bën përllogaritjen e taksës dhe tarifës dhe strukturën që ngarkohet për vjeljen e saj, u konstatua se struktura e DTTV Bashkia Finiq nuk është plotësisht në funksion të planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Në strukturën e DTTV mungon Sektori i Menaxhimit të Borxhit tatimor. Menaxhimi i borxhit tatimor dhe alternimi midis vlerësimit dhe planifikimit është e nevojshme të organizohen në nivel sektori sepse:

- Këto procese kanë natyra të ndryshme pune, arkëtimi i debitorëve është procedurë më vete dhe ka afate të përcaktuara.

- Subjektet debitorë të prapambetur në Bashkinë Finiq kanë peshë si në numër ashtu dhe në vlerë, konkretisht vetëm për kategorinë “Biznes” debitorë të trashëguar nga viti 2022 janë 230 subjekte, pra 100% e subjekteve.

Bashkia Finiq për individët familjarë dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet në territorin e saj, ka miratuar në strukturën e paketës fiskale për vitin 2023 në total 65 taksa/tarifa vendore dhe 20 gjoba për kundërvajtje administrative. Struktura e evidencës së realizimit të të ardhurave për vitin 2023 jep informacion mbi planifikimin dhe realizimin vetëm për 18 taksa dhe tarifa vendore.

Për disa lloje taksash dhe tarifash nuk është përcaktuar qartë struktura e ngarkuar për të bërë përllogaritjen dhe struktura që do të ndjekë vjeljen e taksës ose tarifës përkatëse. Gjithashtu konstatohet se në disa raste për vjeljen e taksave dhe tarifave të ndryshme ngarkohen njëkohësisht më shumë se dy struktura.

Procesi për planifikimin, përllogaritjen e detyrimeve tatimore, ndjekjen e subjekteve debitore për taksa tarifa vendore nuk është i saktë pasi:

- Planifikimi për taksa dhe tarifa vendore nuk është kryer bazuar në rakordimin midis DTTV, DRT dhe QKB për numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në territorin që administron Bashkia Finiq, analizën e rezultatit historik, pritshmërive të vitit korrent dhe koordinimit midis drejtorive që mbulojnë realizimin e tyre.

- Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj., në regjistrin elektronik në formatin EXCEL të DTTV-së nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Kjo ndikon në cilësinë e të dhënave që popullojnë bazën e regjistrit elektronik të DTTV-së, në planifikim dhe në përgatitjen e evidencave të qarta sa i përket identifikimit të subjektit dhe përcaktimit të njoftim detyrimit për t’u paguar lidhur me taksat dhe tarifave vendore.

- Në paketën fiskale nuk identifikohen taksa dhe tarifa vendore për të gjitha kategoritë e bizneseve që zhvillojnë aktivitetet në Bashkinë Finiq, si ATM pajisje elektronike, makineta, lojra për fëmijë, ekranet dixhitalë të reklamimit, karikues për mjetet lëvizëse (që janë të vendosura në hapësira publike, biznese private apo pranë institucioneve të ndryshme etj.), tenda, konstruksione metalike. Mospërfshirja në strukturën e paketës fiskale e të gjitha kategorive të bizneseve që zhvillojnë aktivitetet në Bashkinë Finiq çon në mosplanifikim të disa kategorive biznesesh.

Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2023 nuk jep informacion të plotë mbi të gjitha taksat/tarifave vendore dhe gjobat e aplikuara për kundërvajtjet administrative pasi:

Drejtoritë që administrojnë (Sipas strukturës së Paketës Fiskale) taksat/tarifave vendore nuk mbajnë regjistër për menaxhimin e të dhënave. Vetëm DTTV administron regjistër për menaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifave vendore.

Evidenca e realizimit të të ardhurave për vitin 2023 nuk jep informacion për 73% të taksave/tarifave vendore të miratuara në paketën fiskale për vitin 2023, në vlerë absolute 47 taksa/tarifa.

Në DTTV nuk përcillet informacion lidhur me “Planifikimin” mbi realizimin e pritshëm për taksat/tarifat vendore dhe “Listat e Debitorëve” nga gjithë struktura e ngarkuar për administrimin e të ardhurave, por vetëm nga DTTV për taksat/tarifat që administron.

Sa më sipër “Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2023” dhe “Vlerësimi i gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifat vendore” sipas strukturës së Paketës Fiskale të miratuar nuk janë të plota. Mungon gjurma e auditimit mbi vlerësimin e gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifat vendore.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 5, neni 11; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 7 dhe nenet 20-25 në Kreun IV; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 1, neni 2 gërmat a, ç, neni 5, gërmat a, d, dh, f, g, gj, h, i, neni 6, pikat 1, 2, 3, neni 12, gërmat a, b, dh, neni 13, gërma b, neni 15, neni 23, pika 1, 4, neni 26, neni 27, neni 28, pika 1, neni 29, neni 31, neni 40, neni 41, neni 42, neni 43, pika 1, 2, 3, neni 44, neni 45, neni 47, neni 48, pika 1, neni 57, pikat 4, 5, nenet 60-62, neni 65, pika 5, nenet 68-69, neni 70 pika 2, neni 71/1 pika 5, nenet 88-104; Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 3; Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, neni 2, pika 13 dhe pika 16, nenet 28-40, neni 42, neni 43 gërma d, neni 59; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 12; Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 7, Ligjin nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportele”, Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Kapitulli III, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; Udhëzimin nr. 26, datë 16.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë””; Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007, “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”, neni 12; pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4.; VKB nr. 47 datë 29.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Finiq”;

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. K.K., Kryetar i Bashkisë Finiq deri më 26.06.2023; z. I.N., Drejtor i Drejtorisë së Taksave Tarifave Vendore, znj. L.M., Drejtor i Drejtorisë së Finacës në Bashkinë Finiq; z. V.L., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; z. A.M., Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë; z. Z.K., Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave; z. K.T., Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe z. L.H., Kryeinspektor i Policisë Bashkiake.

#### **Taksat dhe Tarifat e aplikuar dhe arkëtuara nga Bashkia Finiq:**

Sipas Paketës Fiskale për vitin 2023, janë aplikuar/mbledhur 18 lloje taksash dhe tarifash.

Subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Finiq dhe Njësitë Administrative, ndahen në 3 kategori: Biznese, Familjarë dhe Institucione.

Këto kategori (përfshijë institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

- Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh; Biznes i Vogël; Tregëtarët Ambulantë.
- Kategoria e dytë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Llojet e subjekteve mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore dhe numri i tyre janë paraqitur në Aneksin A1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sa i përket ambulantëve, kjo kategori nuk mund të evidentohet. Bashkia Finiq veç taksave dhe tarifave të mësipërme ka planifikuar dhe arkëtuar të ardhura nga disa lloje burimesh të ndryshme, si gjoha nga inspektorati i mbrojtjes së territorit, policia bashkiake, etj.

Të dhënat nga vlerësimi i kryer mbi gjendjen e subjekteve fizike apo juridike në fund të vitit

2022, shtesat apo pakësimet e realizuara gjatë vitit 2023, si dhe gjendja e tyre në fund të vitit 2023, janë paraqitur në Aneksin A2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku konstatohet një rritje e numrit të bizneseve: nga fundi i vitit 2022 që ishin 220 subjekte, (146 persona fizikë dhe 74 persona juridikë), në fund të vitit 2023 kanë qenë 230 subjekte, (158 persona fizikë dhe 72 persona juridikë). Pra ka 10 biznese më shumë (12 PF dhe -2 persona juridikë).

Për vitin 2023, ka regjistrime të reja për 25 persona fizikë dhe mbyllje të aktivitetit nga 20 biznese, përkatësisht 13 persona fizikë dhe 7 persona juridikë.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023, është paraqitur në Aneksin A3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, ku planifikimi dhe realizimi është verifikuar në bazë të të dhënave që disponon Drejtoria e të Ardhurave, duke ju referuar Evidencës mbi realizimin e të ardhurave (taksa e tarifa vendore) për periudhën objekt auditimi, konfirmuar nga Dega e Thesarit Delvinë.

Niveli i të ardhurave në masën 96.18%, ka ardhur si shkak i mosrealizimit në disa zëra, si më poshtë:

- Qeraja nga ndërtesat, ku nga 2,200 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar vetëm 108 mijë lekë ose në masën 5% me një diferencë në vlerë absolute më pak për 2092 mijë lekë.

- Qeraja për 35-99 vite për toka të mbjella, ku nga 2500 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar vetëm 1.432 mijë lekë ose në masën 57,3%, me një diferencë në vlerë absolute me pak për 1068 mijë lekë.

Nga vlerësimi i grupit të auditimit, në lidhje me rezultatin në planifikim dhe në realizim, u konkludua se:

- Nuk ka pasqyrim në planin buxhetor, në regjistër, si dhe në pasqyrat financiare, të një detyrimi prej 5,300 mijë lekë, të trajtuar në auditimin e realizuar nga ana e KLSH me materialin e auditimit të datës 01.11.2022, si “*Tarifë vendore për pajisjen me leje tregtimi për shitjen e karburanteve*”.

- Në disa tarifa apo dhe taksa të cilat janë trajtuar me një realizim të lartë, është konstatuar se nuk ka një bashkërendim me sektorët e tjerë përgjegjës për vlerësimin e detyrimeve sipas parashikimeve dhe burimeve që disponojnë për realizimin e të ardhurave, kjo për hartimin e një buxheti sa më afër realitetit.

- Nga vlerësimi i kryer nga inspektori i të ardhurave në bashki, referuar të dhënave të regjistrimit rezultojnë se në fund të vitit 2022, gjendja e debitorëve ka arritur vlerën 213,212,631 lekë. Arkëtimet mbi vlerat e planifikuara kanë qenë në shumën 79,010,771 lekë dhe jo në vlerën 91,836,344 lekë që figuron në akt rakordimin me thesarin. Diferenca e vlerës prej 12,825,573 lekë, përfaqëson të ardhura të paplanifikuara në buxhetin e vitit ushtrimor si dhe të papasqyruara në regjistrin e të ardhurave.

**Plotësimi i dosjeve të tatimpaguesve me dokumentacion që vërteton sipërfaqen e ndërtesës, truallit, tabelës për qëllim reklamimi, etj.:**

Nga auditimi i regjistrimit të taksapaguesve fizikë/juridikë në Bashkinë Finiq dhe procesit të plotësimit të dosjeve me dokumentacion. u konstatua se:

Ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese nuk realizohet duke rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.

Sa më sipër mungon gjurma e auditimit dhe nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve.

Akt konstatimet nga specialistët e terrenit nuk janë të rifreskuara periodikisht (çdo vit) dhe nuk shprehin qartë objektin për të cilin është kërkuar mbajtja e këtij akt konstatimi. Në asnjë rast Akt konstatimet e mbajtura nuk japin informacion të plotë sa i përket:

- Të dhënave të nevojshme për përcaktimin e bazës së taksës. Ato nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues të njehsuar me origjinalin për llojin e aktivitetit të deklaruar/faktik nga subjekti, adresën e plotë ku ushtrohet ky aktivitet, sipërfaqen në të cilën ushtron aktivitet etj.;

- Gjëndjes debitore që ka subjekti apo që shfaqin aktivitete të mëparshme të administruara prej tij në sistemin e DTTV, ska informacion mbi masat e marra për rastet debitore.

Kjo ndikon cilësinë e të dhënave që popullojnë bazën e regjistrit të taksapaguesve të DTTV, në planifikim dhe në përgatitjen e evidencave të qarta sa i përket identifikimit të subjektit dhe përcaktimit të njoftim detyrimit për t'u paguar lidhur me taksat dhe tarifatat vendore. Të dhënat për këto subjekte janë lehtësisht të verifikueshme në terren apo nga drejtoritë që administrojnë informacion për kryqëzimin e këtij informacioni.

Në asnjë rast në dosje nuk administrohet dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në regjistër, për vlerësimin/ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifatat vendore, pra regjistrimet e të dhënave në regjistrin në format "EXCEL" të taksapaguesve janë bërë pa dokumentacionin justifikues të domosdoshëm që përcakton bazën e taksës.

Vlen të theksohet se në zbatim të nenit 20 të Ligjit nr. 181/2013, datë 28.12.2013 "*Për disa shtesa dhe pakësime në Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"*" nga ana e ZVRPP (AShK) nuk i është paraqitur Bashkisë Finiq regjistri i pasurisë.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5, neni 11, neni 22, pika 3; Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenet 29, 36, 69, 75; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "*Për Arkivat*"; UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar; Manualin e Manaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Kapitulli III, "*Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit*"; VKB nr. 47 datë 29.12.2022, për "*Sistemin e taksave dhe tarifatat vendore në Bashkinë Finiq*".

#### **Vlerësim mbi pasqyrimin e vlerës së debisë të mbartur deri në fund të vitit 2022:**

Nga vlerësimi i bërë mbi pasqyrimin e vlerës së debisë të mbartur deri në fund të vitit 2022, është konstatuar se nga ana e Drejtorisë së Taksave të Bashkisë Finiq është bërë trajtimi analitik i debitorëve, në evidencë të veçantë për çdo lloj detyrimi, duke ndarë detyrimin e viteve të mëparshme nga detyrimi i vitit ushtrimor që ka lindur në fund të vitit.

Në regjistrin ku janë pasqyruar detyrimet për çdo familjar apo dhe biznes, vlera e debisë për çdo debitor është regjistruar në vlerën totale që është në fund të vitit 2023. (Kjo shoqërohet me pasqyrat analitike të debitorëve).

Debia e pasqyruar në regjistër kuadron me vlerën e debisë e cila është pasqyruar në pasqyrat financiare të Bashkisë në fund të vitit 2022.

Referuar të dhënave të pasqyruara në regjistër, nga ana e Drejtorisë së të ardhurave për çdo biznes janë dërguar njoftimet përkatëse si për detyrimet e mbartura ashtu dhe për detyrimet e vitit ushtrimor, ndërsa për detyrimet e familjareve u janë dërguar 1 apo 2 herë nga çdo Njësi Administrative letër-kujtesat për detyrimet përkatëse dhe listat e debitorëve i janë dërguar kryetarëve.

Sipas të dhënave të pasqyruara në regjistrin e të ardhurave që administrohet pranë Drejtorisë së të ardhurave, rezulton se shuma e detyrimeve në fund të vitit 2023 është në vlerën 282,194,774 lekë.

Kjo vlerë përbëhet nga detyrimet e mbartura dhe të paarkëtuara (Debia) deri më 31.12.2022 në vlerën 213,212,633 lekë si dhe detyrimi i vitit ushtrimor 2023 që është 68,982,140 lekë. Vlera e debisë në fund të vitit 2022 prej 213,212,633 lekë është e pasqyruar në regjistër, si në pasqyrat analitike edhe në pasqyrat financiare.

#### **Analiza e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave:**

1. Në planifikimin e detyrimeve familjare për çdo lloj taksë apo tarifë vendore, janë aplikuar tarifatat e miratuara me VKB “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore” për të gjithë periudhën e audituar.

2. Nga Drejtoria e Taksave nuk disponohet dokumentacioni përkatës mbi bazën referuese në llogaritjen e detyrimeve sipas llojit të taksës apo tarifës vendore, për çdo subjekt familjar.

#### Vlerësimi për familjarët:

Përmbledhja e vlerës së debisë të mbartur për taksapaguesit familjare, në çelje të vitit 2023, arkëtimet e realizuara gjatë 2023, si dhe mbetja e kësaj debie në fund të vitit 2023 është paraqitur në Aneksin A4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku rezulton se vlera e debisë për familjarët në datën 31.12.2022 ka qenë 146,664,564 lekë plus detyrimin e vitit ushtrimor 2023, që është 51,372,067 lekë, në total shkon 198,036,630 lekë. Gjatë vitit 2023 nga kjo vlerë, për detyrime që i përkasin gjëndjes debitore më 31.12.2022 janë arkëtuar 18,488,681 lekë, me një mos realizim në vlerë absolute 128,175,883 lekë ose në masën 87.39%. Për detyrimet që i përkasin vitit 2023 është arkëtuar vlera 21,906,053 lekë me një mosrealizim në vlerë absolute 29,466,014 lekë, ose në masën 57.35%. në total gjatë vitit 2023 është arkëtuar vlera 40,394,734 lekë.

Më 31.12.2023 vlera e debisë për familjarët rezulton 157,641,896 lekë Pra ka një rritje të detyrimeve për këtë kategori në shumën 10,977,332 lekë ose 7.48% krahasuar me vitin 2022.

#### Vlerësimi për bizneset:

Nga auditimi u konstatua se janë hapur dosjet personale për çdo biznes, në të cilat ka mangësi të të dhënave sipas kërkesave të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme nr. 655/1 datë 06.02.2007 dhe Ministrisë së Financave me nr. 125/4 datë 31.01.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore” dhe nga vlerësimi i tyre rezultoi se nga 158 subjekte fizike që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Finiq, janë regjistruar pranë QKB dhe disponojnë NIPT 133 subjekte fizike, ndërsa 25 subjekte ushtrojnë aktivitet, paguajnë taksat dhe tarifatat vendore, por nuk figurojnë të pajisur me NIPT nga QKB, përkatësisht:

Në NjA Finiq, nga 93 subjekte, 90 subjekte disponojnë NIPT, ndërsa 3 subjekte janë pa NIPT.

Në NjA Aliko, nga 13 subjekte, 8 subjekte disponojnë NIPT, ndërsa 5 subjekte janë pa NIPT.

Në NjA Dhimër, nga 20 subjekte, 20 subjekte disponojnë NIPT.

Në NjA Mesopotam, nga 49 subjekte, 47 subjekte disponojnë NIPT, ndërsa 2 subjekte janë pa NIPT.

Në NjA Livadhja, nga 55 subjekte, 40 subjekte disponojnë NIPT, ndërsa 15 subjekte janë pa NIPT.

Në lidhje me 20 subjektet të cilat rezultojnë se kanë mbyllur aktivitetin gjatë vitit 2023, të cilat figurojnë të çregjistruara në regjistrin e të ardhurave të bashkisë, nuk disponojnë asnjë lloj dokumentacioni që të faktonte likuidimin e detyrimeve deri në momentin e shkëputjes apo edhe shkresa zyrtare që këto subjekte kanë paraqitur për mbyllje të aktivitetit. Nga vlerësimi i kryer, rezultoi se 4 nga subjektet e mbyllura, pavarësisht mangësive dokumentare në dosjet e subjekteve, figurojnë edhe debitore pranë Bashkisë Finiq, për moslikuidim të taksave dhe tarifave vendore deri në fund të vitit 2022, për vlerën prej 1,757,602 lekë, përkatësisht:

- Subjekti “S.P.A.” shpk me nr. NIPT-i L.....M, rezulton debitor në vlerën 268,520 lekë.

- Subjekti “F.P.P.” shpk, me nr. NIPT-i L.....B, rezulton debitor në vlerën 1,391,102 lekë.

- Subjekti A.A. me nr. NIPT-i L.....C, rezulton debitor në vlerën 66,240 lekë.

- Subjekti N.S. me nr. NIPT-i L.....P, rezulton debitor në vlerën 31,740 lekë.

3. Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit mbi detyrimet që ka çdo subjekt për të paguar taksat dhe tarifatat vendore, duke ju referuar detyrimeve të përcaktuara në paketën fiskale, si dhe regjistrin e llogaritjes së detyrimeve për çdo subjekt dhe çdo lloj detyrimi, u konstatua se:

- në planifikimin vjetor për biznesin e vogël dhe biznesin e madh, figuron vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022, si dhe detyrimet e vitit 2023, për të gjitha bizneset, por

duhet theksuar se detyrimi i mbartur në vite nuk figuron i pasqyruar sipas llojit të detyrimit por është i evidentuar në total.

- në regjistrin e bizneseve është përfshirë debia e mbartur, por kjo debi nuk del sipas llojit të detyrimit për çdo zë taksë apo tarifë vendore.

#### Paraqitja e vlerës së debisë së mbartur, detyrimet e vitit 2023 dhe arkëtimet përkatëse:

Nga auditimi rezultoi se nga vlera e debisë për kategorinë biznes në vlerën 66,548,069 lekë në datën 31.12.2022, detyrimi i vitit ushtrimor 2023 është në vlerën 17,610,074 lekë, në total 84,158,143 lekë. Gjatë vitit 2023 është arkëtuar në total vlera 17,944,192 lekë, nga kjo vlerë është arkëtuar për detyrime që i përkasin gjëndjes debitore më 31.12.2022 vlera 6,718,493 lekë, me një mosrealizim në vlerë absolute prej 59,829,576 lekë (66,548,069 lekë vlera e debisë në datën 31.12.2022, 6,718,493 lekë pagesa për detyrime që i përkasin gjëndjes debitore më 31.12.2022) ose 89.9%. Për detyrime që i përkasin vitit 2023 është arkëtuar vlera 11,225,699 lekë, me një mosrealizim në vlerë absolute prej 6,384,375 lekë (17,610,074 lekë detyrimi i vitit ushtrimor 2023, 11,225,699 lekë pagesat që i përkasin vitit 2023) ose në masën 36.25%.

Nga auditimi rezultoi se detyrimi total për taksapaguesit e kategorisë biznes, në datën 31.12.2023 është 84,158,143 lekë (66,548,069 lekë vlera e debisë me datën 01.01.2023 + 17,610,074 lekë vlera e detyrimit që lindi gjatë vitit 2023). Nga të cilat arkëtuar në total gjatë vitit 2023, 17,944,192 lekë. Më 31.12.2023 vlera e debisë rezulton 66,213,951 lekë. Pra ka një uje të detyrimeve për këtë kategori në shumën 334,118 lekë ose në përqindje të debisë në masën 0.5% krahasuar me vitin 2022, pasqyruar në Aneksin A5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Analiza e përmbledhur e debitorëve të mbartur dhe detyrimet e vitit ushtrimor, për periudhën e audituar:**

Nga auditimi rezultoi se vlera e debisë për kategoritë biznes dhe familjarë në datën 31.12.2022 është 213,212,633 lekë. Detyrimi i vitit ushtrimor 2023 është 68,982,140 lekë, në total 282,194,774 lekë. Gjatë vitit 2023 është arkëtuar në total vlera 58,338,926 lekë, nga kjo është arkëtuar për detyrime që i përkasin gjëndjes debitore më 31.12.2022 vlera 25,207,174 lekë (biznese 6,718,493 lekë + familjarë 18,488,681 lekë), me një mosrealizim në vlerë absolute 188,005,459 lekë ose në masën 88.18%. Nga detyrimet që i përkasin vitit 2023 është arkëtuar vlera 33,131,752 lekë, me një mosrealizim prej 35,850,388 lekë ose në masën 51.97%, pasqyruar në Aneksin A6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Detyrimi total për taksapaguesit biznese dhe familjarë në datën 31.12.2023 ka qenë 223,855,848 lekë (213,212,633 lekë debia në datën 01.01.2023 + 68,982,140 lekë detyrimi i lindur gjatë vitit 2023), nga të cilat gjatë vitit 2023 janë arkëtuar 58,338,926 lekë. Në datën 31.12.2023, vlera e debisë rezulton 223,855,848 lekë, me një rritje të detyrimeve në shumën 10,643,215 lekë ose 5% krahasuar me vitin 2022, pasqyruar në Aneksin A7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku rezulton se nga Drejtoria e të ardhurave të Bashkisë, duhet të bëhet analiza e plotë dhe e detajuar e debisë së pasqyruar në regjistër dhe pasqyrat financiare, analiza e plotë dhe detajuar e të ardhurave që janë me tejkalim apo dhe me mosrealizim sipas zërave, duke vlerësuar bazën e llogaritjes së detyrimeve apo dhe arsyet e tjera që kanë krijuar këtë situatë.

#### **Subjektet që tregtojnë hidrokarbure:**

Nga vlerësimi i kryer mbi subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre në territorin e Bashkisë Finiq, u konstatua se ka mangësi në plotesimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh.:

- Nuk është krijuar një regjistër i posaçëm për këto subjekte, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti.

- Nuk është vepruar në mbledhjen e detyrimeve specifike për kategori biznesi, ku edhe nga KLSH është lënë një detyrim për paisjen me lejet përkatëse për tregtimin e tyre, si dhe nuk është aplikuar tarifa për paisjen me leje tregtimi për karburantet sipas VKMsë nr. 970, datë

02.12.2015, i ndryshuar me Vendimin nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nenprodukteve të saj””, sipas së cilës të gjitha subjektet që iu ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit, pas datës se hyrjes në fuqi të këtij vendimi për rinovimin e licencës, duhet të paguajnë këtë detyrim.

Nga auditimi u konstatua se nga auditimi i mëparshëm që është kryer nga KLSH, kanë rezultuar 5 subjekte me një detyrim të palikuiduar në vlerën 5,300,000 lekë, ndërkohë që nga ana e institucionit nuk është ndërmarrë asnjë veprim.

Në lidhje me këto subjekte është bërë regjistrimi në regjistrin e të ardhurave vetëm për taksat dhe tarifatat vendore, pa trajtuar detyrimet që lindin nga kërkesat e VKM-së nr. 344, datë 19.04.2017. Grupi i auditimit duke marrë në konsideratë vlerën e detyrimit të mësipërm, si dhe duke vlerësuar detyrimin e lindur në vitin 2022, vlerëson se shuma progresive e detyrimit me datë 31.12.2023 është 5,800,000 lekë.

Sipas të dhënave të disponueshme nga Bashkia Finiq, gjendja aktuale e debitorëve për mospagimin e detyrimeve për lejen e tregtimit të hidrokarbureve, është si vijon:

- subjekti “T.V.” ShPK, për detyrimin 1,100,000 lekë është në proces gjyqësor;
- subjekti “K.” ShPK, për detyrimin 1,000,000 lekë është në proces gjyqësor;
- subjekti “G.C.G.” ShPK, rezulton se aktualisht ka likuiduar detyrimin;
- subjektit “B.O.” ShPK, për vlerën 2,200,000 lekë i është bllokuar llogaria bankare dhe është vendosur barrë hipotekore.

Vlerat e detyrimeve, arkëtimet dhe gjendja debitore e këtyre subjekteve në datën 31.12.2022, është paraqitur në Aneksin A8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mosllogaritja e detyrimit nga tarifatat për licencat e tregtimit të karburanteve nga DTTV ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Finiq në vlerën 4,960,000 lekë. Gjithashtu nga ana e kësaj drejtorie nuk janë marrë masa për ripajisjen e subjekteve B.O. me licencën e tregtimit të hidrokarbureve, në kundërshtim me VKM-në nr. 970 datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nenprodukteve të saj”, Kreu II, pikat 3 dhe 14.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. I.N., Drejtor i DTTV; z. T.Z., Përgjegjës i të Ardhurave; z. K.T., Drejtor i Shërbimeve Publike; z. R.B., Kryeinspektor i Sektorit të Terrenit; znj. E.S.; znj. L.S.; z. S.S.; z. S.Ç. dhe z. K.L., Inspektorë të Sektorit të Terrenit.

#### **Dhënia me qira e fondit kullor:**

Nga auditimi, rezultoi se me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar me VKM nr. 134, datë 3.3.2021 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 8.6.2016 të KM “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar”, është miratuar lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Finiq, sipas të cilit janë transferuar gjithsej 21,912.62 ha, nga e cila 12,012.45 ha sipërfaqe kullote, 9,900.17 ha sipërfaqe pyjore dhe 543.35 ha sipërfaqe shkëmbore.

Nga Bashkia Finiq nuk është kryer procedura e aplikimit të regjistrimit të pyjeve dhe kullotave në pronësi të saj pranë ASHK Sarandë, në zbatim të VKM nr. 799, datë 29.09.2010 “Për caktimin e tarifave të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, në të cilën shprehet se procedura për tokën pyjore dhe kullosore kryhet nga njësitë vendore pa tarifa aplikimi. Sa më sipër, nga ana e Sektorit të pyje-kullotave, ngrihet pretendimi se nga ana e Kompanisë D., e cila ka marrë përsipër regjistrimin e tyre, nuk është paraqitur në Bashkinë Finiq asnjë informacion apo produkt përfundimtar. Këto pasuri nuk janë regjistruar, vlerësuar dhe pasqyruar në kontabilitet, në llogarinë 211 “Pyje, kullota dhe plantacione”.



Nga Sektori i pyjeve dhe kullotave është hartuar një regjistër për kullotat e gatshme për sezonin veror 2023, me sipërfaqe totale 5,072.28 ha, nga e cila sipërfaqe kullote 3,515.86 ha, me kapacitet 6,860 krerë dhen, 2,579 krerë dhi dhe 20 krerë bagëti të trasha dhe sipërfaqe pyjore 1,556.42 ha, me kapacitet 3,892 krerë dhi dhe për sezonin dimëror 2022-2023 me një sipërfaqe totale kullimore 9,688.81 ha, nga e cila sipërfaqe kullote 7,733.26 ha me kapacitet kullimosor 22,639 krerë dhen, 3,211 krerë dhi dhe 114 krerë bagëti të trasha dhe sipërfaqe pyjore 1,955.55 ha me kapacitet kullimosor 4889 krerë dhi. Gjithsej, sipërfaqe kullimore e pyjore e planifikuar për dhënie me qera është 14,761.09 ha.

Nga sipërfaqja totale që ka në administrim Bashkia Finiq sipas VKM-ve të mësipërme, është planifikuar për t'u dhënë me qera vetëm 67.36% e saj, duke mos e shfrytëzuar të gjithë sipërfaqen kullimore dhe regjistri nuk është firmosur nga hartuesi i tij, gjë që duhet të ishte bërë me komision të përcaktuar nga titullari me specialistët e fushës.

Sipas këtij regjistri, të ardhurat që do të mblidhen nga këto kullota janë 4,059,300 lekë nga kullotat verore dhe 9,085,400 lekë nga kullotat dimërore, gjithsej 13,144,700 lekë, vlerë kjo, që përputhet me planin e të ardhurave për vitin 2023-2024 protokolluar me nr. 317/1prot., datë 30.11.2022, miratuar nga kryetari i Bashkisë, miratuar në Këshillin Bashkiak me VKB nr. 47 datë 29.12.2022, shprehja e ligjshmërisë me shkresën nr. 31/1 prot., datë 18.04.2023.

Për vitin 2023, me VKB-në nr. 47, datë 29.12.2022, "*Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023*", janë miratuar tarifat për dhënien me qira të sipërfaqeve kullimore e pyjore për kullotje, përkatësisht, për kullota dimërore dhe verore 300 lekë/krerë dhen e dhi, 2,400 lekë/krerë bagëti të trasha njëthundrake dhe 3,000 lekë/krerë bagëti të trasha dythundrake. Këto tarifa janë më të larta se tarifat e përcaktuara në VKM-në nr. 632, datë 11.06.2009 "*Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje*".

Për vitin 2023, nga kjo Bashki janë lidhur 102 kontrata qiraje me afat 6 mujor, nga të cilat 21 kontrata për kullota verore me një sipërfaqe kullimore 1,992.16 ha, në vlerën 1,640,500 lekë dhe 81 kontrata për kullota dimërore me një sipërfaqe 6,164 ha, në vlerën 6,843,100 lekë, gjithsej 8,156.16 ha, në vlerën 8,483,600 lekë.

Pra, për sezonin veror është shfrytëzuar vetëm 13.4% e sipërfaqes së përcaktuar në regjistër dhe të miratuar nga titullari dhe për sezonin dimëror 2022-2023 është shfrytëzuar vetëm 63,6% e sipërfaqes së përcaktuar në regjistër dhe të miratuar nga titullari.

Gjithashtu, janë lidhur edhe 7 kontrata me afat 10 vjeçar, të trashëguara nga ish komunat me një sipërfaqe 565,55 ha për 1,290 krerë dhen dhe 45 krerë bagëti të trasha për vlerën totale vjetore 197,500 lekë, prej të cilave 3 kontratat iu përfundon afati në datën 31.05.2023 dhe 4 prej tyre iu përfundon afati në datën 31.05.2025.

Nga auditimi i dosjeve të kontratave të lidhura, rezultoi se është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016 "*Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari*".

#### **Dhënia me qira e tokave bujqësore të pandara:**

Për periudhën e audituar, nga kjo bashki nuk është lidhur asnjë kontratë për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandara.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave të qirase të lidhura nga ish komunat, sot NjA të kësaj bashkie, rezultoi se nga ish komuna Mesopotam janë lidhur gjithsej 208 kontrata me një sipërfaqe totale 271,3 ha, nga të cilat 195 kontrata me afat 99 vjet dhe 13 kontrata me afat 35 vjet. Nga kontratat e lidhura, 36 kontrata janë lidhur në vitin 2011 ndërsa 172 kontrata janë lidhur në vitin 2013.

Nga këto, me Vendime të Këshillit Bashkiak Finiq janë zgjidhur 20 kontrata për mosrespektim të kushteve të kontratës, konkretisht, 12 kontrata me VKB nr. 46, datë 26.08.2020, konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Vlorë me shkresën nr. 895/1, datë 14.09.2020, 6 kontrata me VKB nr. 54, datë 24.12. 2021 dhe 2 kontrata me VKB nr. 55, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2/1, datë 17.01.2022.

Nga 20 kontratat e zgjidhura me VKB nr. 46, datë 26.08.2020, kontrata e lidhur me subjektin V.R., nuk është zgjidhur, pasi ishte bërë gabim, miratuar me VKB nr. 52, datë 29.12.2022. Pra, janë zgjidhur gjithsej 19 kontrata.

Gjithashtu, nga ish komuna Finiq janë lidhur gjithsej 16 kontrata për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara me një sipërfaqe totale 9,153 ha, nga të cilat 5 kontrata me afat 99 vjet, 5 kontrata me afat 35 vjet dhe 6 kontrata me afat 10 vjet. Këto të fundit e kanë afatin deri me 25.11.2023.

Të gjitha kontratat e lidhura nuk janë noteriale si dhe nuk janë regjistruar në ZVRPP, në kundërshtim me nenin 2, pika “dh” të kontratës tip për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 13, datë 15.1.2013 “Për miratimin e përmbajtjes së “kontratës tip” për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara”.

Nga 208 kontratat e lidhura me ish komunën Mesopotam, janë zbatuar planet e biznesit për mbjellje me ullishte apo dru frutorë në 115 kontrata dhe nuk janë zbatuar në 93 kontrata, ndërsa nga 16 kontratat e lidhura nga ish komuna Finiq janë zbatuar në 7 kontrata dhe nuk janë zbatuar në 9 kontrata.

Nga verifikimi i kryer, rezultoi se në total nga Bashkia Finiq janë lidhur 224 kontrata (208 kontrata nga ish komuna Mesopotam dhe 16 kontrata nga ish komuna Finiq).

### **Debitorë të krijuar në vite nga kontratat e qirave dhe gjendja progresive në datën 31.12.2023:**

#### Ish komuna Mesopotam:

Deri në fund të vitit 2022, rezultojnë debitorë 27 subjekte për shumën totale 15,162,234 lekë, ku 1,392,358 lekë janë detyrimet dhe 13,769,876 lekë janë kamatvonesa për 122 subjekte.

Nga 189 kontrata të lidhura me subjektet nga ish Komuna Mesopotam, për vitin 2023 rezultojnë debitorë 25 subjekte, për shumën totale 1,414,583 lekë.

Nga auditimi, detyrimi total për taksapaguesit me kontratë tokë bujqësore nga ish komuna Mesopotam në datën 31.12.2023 rezulton 15,126,370 lekë, ku 1,417,808 lekë janë detyrimet për 25 kontrata dhe 13,708,562 lekë janë kamatëvonesa për 166 subjekte.

Krahasuar me vitin 2022 ka një ulje të detyrimeve për këtë kategori në shumën 35,864 lekë ose 0.24%. Në datën 31.12.2023, vlera debitore ka qenë 16,576,817 lekë (15,162,234 lekë vlera e debisë në datën 01.01.2023 + 1,414,583 lekë vlera e detyrimit të lindur gjatë vitit), nga të cilat gjatë vitit 2023 janë arkëtuar 1,450,447 lekë, me një mosrealizim prej 15,126,370 lekë, ose 91.95%.

#### Ish komuna Finiq:

Nga 16 subjekte të ish komunës Finiq, për vitin 2023 rezultojnë debitorë për shumën totale 71,404 lekë, ku 71,404 lekë është detyrimi vjetor dhe 0 lekë është kamatëvonesa.

Përsa i përket debitorëve të krijuar në vite, deri në fund të vitit 2022, rezultojnë debitorë 14 subjekte për shumën totale 1,635,510 lekë, ku 272,247 lekë janë detyrimet dhe 1,363,263 lekë janë kamatëvonesa.

Nga auditimi, detyrimi total për taksapaguesit me kontratë tokë bujqësore nga ish komuna Finiq në datën 31.12.2023 rezulton 1,681,722 lekë, ku 307,824 lekë janë detyrimet për 25 kontrata dhe 1,373,898 lekë janë kamatëvonesa.

Krahasuar me vitin 2022 ka një rritje të detyrimeve në shumën 46,212 lekë ose 2.83%. Në datën 31.12.2023, vlera debitore ka qenë 1,706,913 lekë (1,635,510 lekë vlera e debisë në datën 01.01.2023 + 71,404 lekë vlera e detyrimit të lindur gjatë vitit), nga të cilat gjatë vitit 2023 janë arkëtuar 38,546 lekë, me një mosrealizim prej 1,668,367lekë, ose 97.74%.

Gjithsej, detyrimi i paarkëtuar së bashku me kamatëvonesën për të gjitha kontratat është 16,808,092 lekë, (15,126,370 lekë debitorët e ish komunës Mesopotam + 1,681,722 debitorët e ish komunës Finiq), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Finiq.

Ndjekja e arkëtimit të detyrimeve bëhet nga Drejtoria e Tatim Taksave.

Nga ana e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së tokës nuk janë kryer kontrole periodike nëse janë përmbushur kushtet e kontratës së qirasë brenda afateve kohore me procesverbale të rregullta, nuk janë hartuar dhe dërguar njoftim detyrimet për pagesën e detyrimit të qerasë, si dhe nuk janë zgjidhur kontratat për 74 subjekte që nuk kanë përmbushur kushtet e kontratës.

Nga ana e Bashkisë nuk është bërë përditësimi, inventarizimi dhe regjistrimi në AShK i tokave bujqësore të pandara në pronësi të saj, në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme, publike, shtetërore”.

Si konkluzion, rezulton se nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, nuk janë kryer kontrole nëse janë zbatuar kushtet e kontratave të lidhura si dhe nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë e Tatim Taksave për ndjekjen e arkëtimit të detyrimeve, si dhe nuk janë zbatuar sanksionet përkatëse deri në zgjidhjen e kontratës me këto subjekte, në kundërshtim me Ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, VKM nr. 531, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, si dhe me Urdhërin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 13, datë 15.1.2013, “Për miratimin e përmbajtjes së “kontratës tip” për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara”, neni 5.

#### **Auditim mbi administrimin e ujitjes dhe kullimit:**

Nga auditimi u konstatua se në paketën fiskale të vitit 2023, paragrafi “Tarifat që do të përdoren për ujitjen e tokave bujqësore”, janë miratuar tarifat për ujitjen e tokave bujqësore, sipas kërkesave të Ligjit nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, neni 19 “Miratimi i tarifave”, për administrimin e të cilave janë ngarkuar Drejtoria e Bujqësisë, Sektori i menaxhimit të ujrave, si dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe Pronave Publike.

Nga Bordi i Kullimit Fier, në zbatim të kërkesave të VKM-së nr.1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga MBZhR dhe Administratës së Ujrave të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme”, është bërë transferimi i infrastrukturës ujitëse dhe kulluese, ku për Bashkinë Finiq është mbajtur procesverbali i datës 24.03.2016, nga përfaqësuesit e Bordit Rajonal të Kullimit Fier, me përfaqësuesit të Bashkisë Finiq, në prezencë të përfaqësuesit të Prefekturës Vlorë, mbi transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit si dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme, nga ku rezulton se Bashkisë Finiq i është transferuar Skema kulluese Bashkia Finiq (Total aftësi kulluese) 4,627 ha dhe Skema ujitëse Bashkia Finiq (Total aftësi ujitëse) 9,550 ha, e përbërë nga:

- Aftësi ujitëse me kanale (rrjedhje e lirë) gjithsej 6,308 ha.
- Aftësi ujitëse me rezervuare (rrjedhje e lirë) gjithsej 2,346 ha.
- Aftësi ujitëse me stacione pompimi gjithsejt 896 ha.
- Disponohen 8 rezervuare me aftësi vaditëse prej 581 ha.

Me procesverbalin e datës 08.06.2016, është marrë në dorëzim nga Bashkia Finiq mjete i llojit Eskavator model Benati i Tipit 316.

Me proces verbalin e datës 06.04.2017, është marrë në dorëzim nga Bashkia Finiq mjete i llojit Eskavator model Volvo i Tipit EC220D.

Nga auditimi u konstatua se:

1. Nuk disponohej plani i masave për vënien në gatishmëri të veprave ujitëse dhe kulluese.
2. Nuk ekzistonte programi i ujitjes apo dhe kullimit, ku të ishin pasqyruar qartë:
  - Evidentimi i kulturave bujqësore të mbjella dhe sipërfaqet përkatëse, për çdo fermer.
  - Përcaktimi i nevojave për ujë për ujitje për çdo fermer.
  - Hartimi i grafikut paraprak të ujitjes.
  - Evidentimi i gjendjes fizike të skemave ujitëse, për dërgimin e ujit në parcela.
  - Evidentimi i gjendjes fizike të kanaleve ujitës dhe kullues.
3. Nuk është realizuar “Monitorimi” i shpërndarjes së ujit për ujitje, konkretisht:
  - Monitorimi i shpërndarjes së ujit për fermeret mbi bazën e sipërfaqes.
  - Monitorimi i evidencës për numrin e ujitjeve, sasinë e ujit, sipërfaqen e ujitur, për çdo fermer.

- Monitorimi i realizimit të punimeve në kullim.

Referuar Informacionit të Drejtorisë së Ujitjes e Kullimit, pa datë, trajtohet se detyrimi i paraqitur pranë Drejtorisë së të ardhurave të Bashkisë është bërë në bazë fshati, pa përcaktuar kriteret bazë që janë kërkesat e Ligjit nr. 24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, kreu IV, neni 15 “Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive”, neni 16 “Burimet e të ardhurave” pasi nuk janë përcaktuar dhe ndjekur tarifat për mirembajtjen e infrastrukturës së ujitjes apo kullimit, si dhe nuk ka tarifë të qartë në shërbim sipas kërkesave të nenit 18, “Tarifa e shërbimit të ujitjes”.

Sipas tabelës së vënë në dispozicion nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes e Kullimit të Bashkisë mbi “Të dhënat për sipërfaqen e tokës së mbjellë dhe tarifat e ujitjes në lekë/ha sipas fshatrave”, rezulton se:

- Sipërfaqja e tokës së mbjellë gjithsej, sipas NjA dhe fshatrave është 5,565,3 ha.

- Sipërfaqja e tokës së ujitur gjithsej, sipas NjA dhe fshatrave është 1.074,5 ha.

Nga kjo:

- Ujitur me rrjedhje të lirë, 703,5 ha;

- Ujitur me ngritje mekanike, 371 ha.

Bazuar në tarifat e përcaktuara në paketën fiskale për vitin 2023, janë planifikuar si detyrim 1,778,000 lekë, e cila përbëhet:

- Nga sipërfaqja e planifikuar për vaditje me rrjedhje të lirë 703,5 ha x 2,000 lekë/ha = 1,407,000 lekë.

- Nga sipërfaqja e planifikuar për vaditje me ngitje mekanike 371 ha x 1.000 lekë/ha = 371.000 lekë.

Nga vlerësimi pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Finiq, rezulton se për vitin 2023, detyrimi i llogaritur për 3,335 familje është 1,650,000 lekë.

Nga ky detyrim gjatë vitit 2023 nga 1,372 familje janë arkëtuar 1,640,125 lekë.

Nga verifikimi i kryer, rezultojnë debitorë për vitin 2023, për shumën totale 1,789,466 lekë.

Ndërsa, përsa i përket debitorëve të krijuar në vite, deri në fund të vitit 2022, (kjo sipas të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave), në datën 01.01.2023 figurojnë 3,454 familje për vlerën 3,465,404 lekë.

Grupi i auditimit vlerëson detyrimin total për taksapaguesit familjar për tarifën e vaditjes 5,254,870 lekë (3,465,404 lekë vlera e debisë me datën 01.01.2023 + 1,789,466 lekë vlera e detyrimit që lindi gjatë vitit 2023 = 5,254,870 lekë), nga të cilat arkëtuar në total gjatë vitit 2023, vlera 1,640,125 lekë, me një mosrealizim prej 3,614,745 lekë ose 68.79%.

Në datën 31.12.2023 vlera e debisë rezulton 3,614,745 lekë, me një rritje të detyrimeve për këtë kategori në shumën 149,341 lekë ose 4.31% krahasuar me vitin 2022 .

Nga grupi i auditimit u konstatua se:

- Nuk disponohet asnjë procesverbal i rregullt monitorimi i sipërfaqes që figuron nën ujë, ku sipas procesverbalit të Bordit, sipërfaqja e transferuar është 9,550 ha, sipas evidencave të Drejtorisë së Bujqësisë (Sektori i Ujitjes dhe Kullimit) figuron sipërfaqe e mbjellë nën ujë 5,565.3 ha, pa përcaktuar se me çfarë kultura është mbjellë, ku në fakt në statistikat e këtij sektori specifikohet se nga sipërfaqja e mbjellë janë vaditur vetëm 1,074,5 ha, ku dhe për këtë nuk ka asnjë proces verbal monitorimi.

Pra kemi një sipërfaqe prej 4,491 ha, nga sipërfaqja e mbjellë për të cilën nuk trajtohet asnjë lloj detyrimi vaditjeje (sip. e mbjellë 5,565,5 ha - sip. e vaditur 1,074,5 ha).

- Nuk disponohet asnjë akt marrëveshje mes fermerëve apo dhe fshatarëve me Bashkinë, mbi kërkesën që kanë për vaditje në referencë të kulturave që disponojnë, mbi bazën e së cilës do të bëhej edhe llogaritja e shpërndarjes së ujit sipas nevojave apo dhe llogaritja e detyrimit për shërbimin që do të kryhej.

- Evidenca e të dhënave mbi bazën e llogaritjes së detyrimit, nga ana e Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, është përcaktuar në sipërfaqe të mbjellë, sipërfaqen e vaditur sipas llojit të vaditjes

(me rrjedhje të lirë apo me ngritje mekanike), referuar tarifave të paketës fiskale, por në Drejtorinë e Taksave në regjistrin e detyrimeve figuronin në bazë familjesh, ku për vitin 2022 figuronin se është vaditur nga çdo familje vetëm 0.26 ha ose 317 lekë/ha.

Për këtë nuk disponohet asnjë e dhënë e pasqyruar me akt konvertimi i tarifës në varësi të sipërfaqes së mbjellë dhe mënyrës së ujitjes sipas pikës “ç” të paketës fiskale.

- Nuk disponohet asnjë lloj monitorimi që të përcaktojë detyrimin sipas kërkesave të paketës fiskale për “*pikën e lidhjes në ujësjellësat e rezervuareve, poshtë saraqineskës së ujësjellësit*”, që ka tarifën 1,500 lekë.

- Nuk na është vënë në dispozicion asnjë lloj njoftimi dërguar për detyrimet e mbartura apo dhe për detyrimin e vitit ushtrimor të fermerëve apo familjeve debitore, në një moment që ky detyrim në fund të vitit 2022, vetëm për sipërfaqen që pretendohet se është vaditur është 3,465,404 lekë.

Mungesa e një evidentimi të plotë dhe të saktë të të dhënave për sipërfaqen e tokës që mbillet sipas llojit të kulturave për çdo fermer, hartimin e planit të masave për krijimin e gatishmërisë së sitemit të ujitjes dhe kullimit, për përballimin e nevojave, si dhe planifikimi i realizimit të të ardhurave për shërbimin që kryejnë, tregojnë për një performancë të dobët nga ana e kësaj njësie shërbimi.

Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar,

Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”;

Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar;

Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”,

Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”,

Ligjin nr. 24/2017 datë 09.03.2017 “*Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit*”

Ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 “*Për tokat bujqësore të pandara*”, i ndryshuar, VKM nr. 531, datë 26.03.1998 “*Për tokat bujqësore të pandara*”;

VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “*Për transferimin nga MBZhR dhe Administratës së Ujrave të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme*”;

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”*”;

UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të vetëqeverisjes vendore*”;

Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr. 2, datë 20.07.2016 “*Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënie të tyre për kullotje e kositje bari*”.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. K.K., me detyrë ish Kryetar i Bashkisë Finiq, deri në datën 23.06.2023; z. R.Ç., me detyrë Kryetar aktual i Bashkisë Finiq dhe z. I.N., me detyrë Drejtor i të Ardhurave Vendore.

**2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

**2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

**2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.**

**2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.**

**2.3.4. Verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale, sa prej tyre janë me çertifikatë pronësie.**

### **Hartimi i pasqyrave financiare:**

Për vitin 2022, në përputhje me kërkesat e UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme””, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

Formati nr. 1: Pasqyra e pozicionit financiar;

Formati nr. 2: Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);

Formati nr. 3: Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow);

Formati nr. 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;

Formati nr. 5: Pyetësor dhe shënimet shpjeguese;

Formati nr. 6: Investimet dhe burimet e financimit;

Formati nr. 7/a: Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike);

Formati nr. 7/b: Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto);

Formati nr. 8: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

### **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:**

Pasqyrat financiare të Bashkisë Finiq, për vitin 2023 janë nënshkruar nga z. R.Ç., Kryetar i Bashkisë Finiq në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. L.M., me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Financës (hartuesi i llogarive vjetore) në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë depozituar pranë Degës së Thesarit Delvinë në datën 27.03.2024, dhe janë konfirmuar në datën 31.03.2024, brenda afatit ligjor.

### **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke, (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, u konstatua se nuk ka diferencë. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

### **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitja e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:**

Për t’u siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

Mosndryshueshmërinë e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor’

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

### **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera, pohojmë se:

Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në programin “EXCEL” dhe jo me program të veçantë.

Nuk janë zbatuar plotësisht parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

Në tërësi, organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues jo në të gjitha rastet është bërë në mënyrë të plotë, pasi nuk përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, nuk përmban të gjitha të dhënat për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë hartuar me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues, si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësi, duke argumentuar shkakun e veprimit, të shoqëruar me urdhërat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshëm për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

### **Baza e dhënies së opinionit të raportimit financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Finiq për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023, rezultoi se llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Delvinë për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës, rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në CASH për vitin 2023.

Materialiteti për shpenzimet është vlerësuar 5,073,406 lekë, ndërsa për të ardhurat është vlerësuar 6,478,404 lekë. Për llogaritja e vlerës së materialitetit është paraqitur në Aneksin PF01, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023, Bashkia Finiq:**

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve

në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Për vitin 2023, Kryetari i Bashkisë Finiq ka nxjerrë Urdhërin nr. 117, datë 30.11.2023, me objekt *“Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të institucionit dhe Njësive Administrative Aliko, Mesopotam, Livadhja dhe Dhivër”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se procesi i inventarizimit përgjithësisht është kryer nga të njëjtët persona pjesëmarrës në komisionet e viteve të kaluara. Ky veprim është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, pika 84.

Pas përfundimit të procesit të inventarizimit, nga komisioni i inventarizimit është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t’i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit.

Nga komisioni i inventarizimit është mbajtur përmbledhësja dhe lista e aktiveve të cilat janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, u konstatua se nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit për llogarinë 202 *“Studime dhe kërkime”* (pjesërisht për ish-Komunën Mesopotam dhe Finiq për analizën përpara vitit 2015, aktive të transferuara) dhe llogarinë 212 *“Ndërtime dhe konstruksione”* (pjesërisht për ish-Komunën Livadhja dhe Finiq për analizën përpara vitit 2015, aktive të transferuara). Kjo problematikë është trajtuar në mënyrë të hollësishme në vijim të materialit konkretisht në analizën e llogarisë 202 *“Studime dhe kërkime”* dhe llogarisë 212 *“Ndërtime dhe konstruksione”*.

Me Urdhërin nr. 719 prot., datë 29.03.2023, të Kryetarit të Bashkisë Finiq, është ngritur komisioni për konstatimin e aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara të dëmtuara për shkak të zjarrit të rënë në zyrën e Burimeve Njerëzore të Bashkisë në datën 25.03.2023. Komisioni pasi ka bërë konstatimin e dëmeve të shkaktuara, ka hartuar listën e pajisjeve të dëmtuara, të shoqëruar me relacionin përkatës.

Me Urdhërin nr. 719/1 prot., datë 29.03.2023, të Kryetarit të Bashkisë Finiq, është ngritur komisioni i vlerësimit për aktivet e trupëzuara dhe të patrupëzuara të dëmtuara, të propozuara për t’u nxjerrë jashtë përdorimit nga komisioni i inventarizimit. Nga komisioni i vlerësimit është mbajtur procesverbal i datë 03.04.2023, ku janë propozuar për të nxjerrë jashtë përdorimit aktive në vlerën totale 512,492 lekë, shoqëruar me relacionin përkatës. Materiali i mësipërm, i shoqëruar me relacionin përmbledhës të miratuar nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues, është paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak dhe është miratua me VKB nr. 44, datë 27.10.2023.

Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/a, *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve Afatgjata (kosto historike)”*, u konstatua se vlera 512,492 lekë është pasqyruar si nxjerrje jashtë përdorimit në referencën e llogarisë 21-28, *“Totali i Aktiveve Afatgjata Materiale”*, llogaria 218 *“Inventar ekonomik”*, ndërkohë që këto aktive nuk janë nxjerrë jashtë përdorimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, *“Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo Materiale”*, i përmirësuar, *“Çregjistrimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale”*, pika 73 dhe pika 74.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u konstatua si më poshtë:

Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet për vlerën **2,469,347,334 lekë**. Aktivet neto janë paraqitur në Aneksin PF1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.



Aktivitet Afatshkurtra janë në vlerën **401,642,109 lekë**. Aktivitet Afatshkurtra janë paraqitur në Aneksin PF1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga testet e kryera në lidhje me përlllogaritjen e amortizimit, u konstatua se përgjithësisht normat e amortizimit janë aplikuar sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

## **A. AKTIVET**

### **I. Aktivet Afatshkurtra**

**1. Llogaritë e Klasës 5, “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”**, janë paraqitur në Aneksin PF3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku u konstatua se vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, në shumën 94,083,697 lekë përbëhet nga gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor”, në vlerën 39,503,003 lekë (fondi i trashëguar përbëhet nga: 3,713,636 lekë të ardhurat e veta + 6,094,335 lekë transferta e pakushtëzuar + 24,911,462 lekë transferta specifike) dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në vlerën 54,580,694 lekë. Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

**2. Llogaritë e Klasës 3, “Gjendje inventari qarkullues”**, janë paraqitur në Aneksin PF4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku u konstatua se llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2023, paraqiten në vlerën 19,541,237 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 5,378,696 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 14,162,541 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 2,226,466 lekë dhe kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” për të njëjtën vlerë.

**Llogaria 312, “Materiale”**, ka vlerën 5,378,696 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 janë paraqitur në Aneksin PF5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 327, “Inventar i imët”**, ka vlerën 14,162,541 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 janë paraqitur në Aneksin PF6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**3. Llogaritë e Klasës 4, “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”**, janë paraqitur në Aneksin PF7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku u konstatua se gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet më datën 01.01.2023 në vlerën 235,532,290 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 245,979,025 lekë, me një rritje në vlerën 10,446,735 lekë. Nga auditimi u konstatua se Bashkia Finiq disponon dokumentacionin justifikues për regjistrimin e kësaj vlere, e cila përbëhet nga debitorë (subjekte dhe individë) në vlerën 22,123,177 lekë dhe debitorë për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 223,855,848 lekë.

Në mënyrë analitike, të dhënat e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, janë paraqitur në Aneksin PF8 dhe PF8/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave dhe Pronave Publike të cilat janë paraqitur pranë Drejtorisë së Financës, është pasqyruar vlera e detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore sipas Aneksit PF9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 42,038,150 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare për të njëjtën shumë. Vlera 42,038,150 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivitet të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe përbëhet nga analiza e paraqitur në Aneksin PF10 dhe PF10/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, në zbatim të UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Seksioni 3.1.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

## **II. AKTIVET AFAT GJATA**

### **1. Aktivet Afatgjata Jomateriale**

**Llogaria 202, “Studime dhe kërkime”,** në datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 13,934,420 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 9,000,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 27,242,667 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 15,550,192 lekë. Analiza e detajuar e kësaj llogarie është paraqitur në Aneksin PF11 dhe PF11/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku u konstatua se në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, është përfshirë vlera 8,030,494 lekë e cila është e paanalizuar sipas studimeve dhe projekteve. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq, Livadhja, Dhivër dhe Mesopotam si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Finiq.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”” Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5.

Analiza e detajuar për sistemimin e llogarisë nga viti 2022 (vlera e paanalizuar), është paraqitur në Aneksin PF12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në këtë llogari është kontabilizuar edhe vlera 3,369,024 lekë kosto historike e cila i përket 2 projekteve “Projektim rikonstruktion rruga Dermish-Cerkovicë (viti 2017)” në vlerën 941,623 lekë dhe “Projekt rehabilitimi i kanalit Filipeu”, në vlerën 2,427,401 lekë, të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim. Për pasojë, vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë, por e mbivlerësuar për shumën 3,369,024 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II, “Aktivet e Qëndrueshme të Patrupëzuara” pika 1/b “Klasifikimi kontabël” dhe UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

### **2. Aktivet Afatgjata Materiale**

Transferimi i pasurive në qeverisjen vendore, tashmë të konsoliduar në Bashkinë Finiq, për llogaritë 210, 211 dhe 212, është bërë me aktet e mëposhtme:

1. VKM nr. 1171, datë 25.11.2009, “Për transferimin e pronave Komunës Finiq”;
2. VKM nr. 763, datë 07.11.2012, “Për transferimin e pronave Komunës Aliko”;
3. VKM nr. 129, datë 03.02.2008, “Për transferimin e pronave Komunës Dhivër”;
4. VKM nr. 1489, datë 12.11.2008, “Për transferimin e pronave Komunës Livadhja”;
5. VKM nr. 857, datë 04.12.2012, “Për transferimin e pronave Komunës Mesopotam”.

Pasuritë e transferuara në ish komunat e konsoliduara në Bashkinë Finiq, janë paraqitur në Aneksin PF13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për gjithë sipërfaqet e transferuara sipas VKM-ve më sipër, Bashkia Finiq nuk disponon tituj pronësie, nuk ka bërë vlerësim të aseteve dhe nuk i ka paraqitur në kontabilitet.

Mosregjistrimi në ASHK, mosvlerësimi dhe mosparaqitja në kontabilitet e aktiveve, është në kundërshtim me VKM-në nr. 510, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të

*gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI, “*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur dhe në Pasqyrat Financiare nuk paraqitet vlera e saktë e aseteve të kësaj Bashkie, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c”.

**Llogaria 210, “Toka, troje, terrene”**, në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 300,000 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime dhe në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet e pandryshuar në vlerën 300,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210, “*Toka, troje, terrene*”, për koston historike në vlerën 300,000 lekë, Bashkia Finiq nuk posedon titull pronësie.

Gjithashtu, Bashkia Finiq nuk ka marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, në total 277 troje objektsh, me sipërfaqe 102,007 m<sup>2</sup>, 127 ngastra toke me sipërfaqe 22,918,856 m<sup>2</sup> dhe 223 ha, si dhe 413 ngastra trojesh, me sipërfaqe 1,048,038 m<sup>2</sup>.

Sa më sipër, është në kundërshtim me VKM-në nr. 510, datë 14.08.2001, “*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI, “*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”, pika 1 dhe 2, si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pika 35, gërmat “a”, “b” dhe “c”.

**Llogaria 211, “Pyje, kullota, plantacione”**, në datën 01.01.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në këtë llogari nuk janë pasqyruar 855 ngastra me sipërfaqe totale 15,570,857 m<sup>2</sup> dhe 22,477.4 ha pyje dhe kullota.

Sa më sipër është në kundërshtim me VKM-në nr. 134, datë 03.03.2021, “*Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”*”.

**Llogaria 212, “Ndërtime dhe konstruksione”**, në datën 01.01.2023 paraqitet në vlerën neto 253,375,721 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 262,646,713 lekë. Sipas Formatit nr. 7/B “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 328,314,637 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 306,212,585 lekë, me një diferencë në rritje prej 22,102,052 lekë, të cilat përfaqësojnë shtesat e krijuara me pagesë si rezultat i investimeve të kryera për rritjen e AQT, në vlerën 22,070,052 lekë dhe vlera 32,000 lekë sistemim (mbikëqyrja e shkollës Mesopotam), kalim nga llogaria 213. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Anekset PF15 dhe PF15/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se në gjendjen e llogarisë 212 “*Ndërtime konstruksione*”, për vlerën historike 292,008,026 lekë, është përfshirë vlera 99,236,804 lekë, e paanalizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq dhe Livadhja. Vlera e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Analiza e detajuar për sistemimin e llogarisë nga viti 2022 (vlera e paanalizuar), është paraqitur në Aneksin PF16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”*”, Kreu II, pikat 5, 36 dhe Kreu III, pika 30.

**Llogaria 213, “Rrugë rrjete vepra ujore”,** në datën 01.01.2023, ka qenë 2,233,295,408 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa 244,491,681 lekë dhe amortizim të akumuluar 115,462,800 lekë, pakësime 560,249,388 lekë, e cila përbëhet nga vlera e objektit të Ujësjetës të Burimeve të Merkos, e cila ka kaluar në administrim të Ujësjetës Rajonal ShA Sarandë me VKB nr. 23, datë 21.07.2023. Në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto 1,802,074,901 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Anekset PF17 dhe PF17/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, pasqyruar në bilanc për vlerën historike 1,878,456,735 lekë, është përfshirë vlera 9,999,347 lekë, që i përket investimit të papërfunduar për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Karroq”, me vlerë 9,999,347 lekë, si dhe llogaritja e amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, si dhe UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme””, Kreu II, pika 5, 36 dhe Kreu III, pika 30.

**Llogaria 214, “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”,** në datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 37,005,013 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa. Amortizimi i akumuluar është në vlerën 32,078,792 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,926,221 lekë.

**Llogaria 215, “Mjete transporti”,** në datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 12,886,903 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime dhe amortizim të akumuluar në vlerën 69,722,974 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 11,108,511 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Anekset PF18 dhe PF18/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 218, “Inventar ekonomik”,** në datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 49,443,249 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 4,988,668 lekë, pakësim në vlerën 512,492 lekë dhe amortizim i akumuluar në vlerën 46,727,035 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto 7,192,390 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Anekset PF19 dhe PF19/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota dhe plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, u konstatua se janë pjesërisht të paanalizuara, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive, për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 6, UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26-30, pika 74, dhe UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme””, Kreu II, pika 5, 36 dhe Kreu III, pika 30.

Për aktivet që i përkasin llogarive 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje, kullota dhe plantacione*”, 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, për koston historike 2,539,844,998 lekë, Bashkia Finiq nuk posedon titull pronësie.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001, “*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI, “*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”, pikat 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, Kapitulli III, pika 35.

Gjendja e **Ilogarisë 231**, “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2023 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat, për vlerën 23,056,648 lekë, që i përkasin llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, për objektin “*Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navaricë*”, me vlerë të kontraktuar 32,179,880 lekë me TVSh. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0 lekë, kur ka investime në proces, pra vlera e kësaj llogarie duhej pasqyruar në vlerën gjithsej 23,056,648 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*”, Aneksi 1, Klasa 23.

## **B. PASIVET (DETYRIMET)**

### **I. Pasivet Afatshkurtra.**

#### **1. Llogaritë e pagueshme**

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Finiq në datën 31.12.2022 kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., sipas paraqitjes në Aneksin PF4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 401-408**, “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”, në datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 6,662,374 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 24,403,280 lekë dhe pakësim në vlerën 30,300,055 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 765,600 lekë e cila përbëhet nga 1 shpenzim për blerje mallrash me faturën nr. 32, datë 18.12.2023 në vlerën 765,600 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”, është paraqitur në Aneksin PF21, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 42**, “*Detyrime ndaj personelit*”, referuar pasqyrave financiare për vlerën 10,843,404 lekë, përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2023, e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. Gjendja e llogarisë 42, “*Detyrime ndaj personelit*”, është paraqitur në Aneksin PF22, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sipas dokumenteve të Thesarit për muajin janar të vitit 2024, u konstatua se vlera e kontabilizuar në llogarinë “*Detyrime ndaj personelit*” është 10,483,404 lekë, e barabartë me urdhër shpenzimet e realizuara nëpërmjet Degës së Thesarit Delvinë, duke u bazuar në dokumentacionin justifikues. Këto të dhëna janë paraqitur në Aneksin PF23, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 431**, “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*”, paraqitet në vlerën 541,709 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor. Detajet e kësaj llogarie janë paraqitur në Anekset PF24 dhe PF24/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqesin vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023, të cilat paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 1,735,334 lekë dhe 196,731 lekë, sipas Anekseve PF25, PF25/1 dhe PF25/2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 466, “Kreditorë për mjete nën ruajtje”**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Finiq, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 54,580,694 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Finiq, sipas akt-akordimit datë 06.02.2024. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Aneksin PF26 dhe PF26/1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për 19 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Finiq, janë ngurtësuar fonde në vlerën 17,467,104 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Delvinë dhe për to është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Kombëtare dhe Administrative dhe Drejtoria e Financës janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 17,467,104 lekë ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

**Llogaria 467, “Kreditorë të ndryshëm”**, ku paraqiten faturat e palikuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 41,559,983 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 104,325,113 lekë dhe pakësime në vlerën 117,929,727 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie është 27,955,372 lekë. Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 27,955,372 lekë, ku së bashku me llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në vlerën 765,600 lekë, llogarinë 42 “Detyrime ndaj personelit”, në vlerën 10,843,404 lekë, llogarinë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, në vlerën 541,709 lekë, llogarinë 435 “Sigurime shoqërore”, në vlerën 1,735,334 lekë, llogarinë “Sigurime shëndetësore” në vlerën 196,731 lekë dhe vendimet gjyqësore në vlerën 122,400 lekë, në total kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 42,058,150 lekë”. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Aneksin PF27, PF27/1, PF27/2 dhe PF27/3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Llogaria 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)”**, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Finiq në datën 01.01.2023, paraqitet në vlerën 235,532,290 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF28, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

## **TË ARDHURAT**

### **1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:**

**Llogaria 70, “Të ardhurat nga taksat e tatimet”**, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 42,281,793 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 43,674,241 lekë ose me rritje në vlerën 1,392,448 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet është paraqitur në Aneksin PF29, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **2. Të ardhurat jo tatimore:**

**Llogaria 71, “Të ardhura jo tatimore”**, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 21,972,945 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 34,658,870 lekë se me rritje në vlerën 12,685,925 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore është paraqitur në Aneksin PF30, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **3. Të ardhura të tjera:**

**Llogaria 72, “Grante korente”,** në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 295,605,926 lekë ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 321,568,351 lekë ose me rritje në vlerën 25,962,425 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente është paraqitur në Aneksin PF31, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **SHPENZIMET**

#### **1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:**

**Llogaria 600, “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”,** në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 118,520,640 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 136,464,154 lekë ose me rritje në vlerën 17,943,514 lekë.

**Llogaria 601, “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”,** në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 19,874,265 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 22,327,689 lekë ose me rritje në vlerën 2,453,424 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Delvinë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është paraqitur në Aneksin PF32, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **2. Blerje mallra dhe shërbime:**

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

**Llogaria 602, “Blerje mallra dhe shërbime”,** në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 86,094,650 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 56,685,005 lekë ose me zbritje në vlerën 29,409,645 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Delvinë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime është paraqitur në Aneksin PF33, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **3. Subvencionet:**

Përfshihen ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Finiq nuk ka pasur subvencione.

#### **4. Transferime korente:**

**Llogaria 604, “Transferime korente të brendshme”,** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 5,404,578 lekë, e cila përputhet me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “*Transferime për Buxhetet familjare e Individë*”, paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 92,291,795 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin, sipas Aneksit PF34, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Për vitin 2023,** totali i të ardhurave në vlerë është 399,901,462 lekë dhe totali shpenzimeve është 360,398,459 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 39,503,003 lekë, rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “*Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor*”, për të njëjtën vlerë.

#### **Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë dhe rregullaritetin e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkuara nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të konfirmuara nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi, përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë, u konstatua se është zhvilluar 1 projekt për pritje-përcjellje, për të cilin nuk janë zhvilluar procedurat e prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjin nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën””, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 8, konkretisht me faturën nr. 3, datë 17.06.2023, me objekt “Aktivitet pritje përcjellje për vitin 2023”, me përfitues OE K.T., në vlerën 500,800 lekë, sipas urdhërit të shpenzimit nr. 588, datë 20.12.2023.

Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e këtyre shpenzimeve është kryer sipas VKB nr. 48, datë 29.12.2022 dhe shprehja e ligjshmërisë me shkresën nr.31/1 prot., datë 18.01.2023. Nga Bashkia Finiq për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.202, për 1 OE është likuiduar shuma 500,800 lekë. Vlera 500,800 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.

### **5. Personeli dhe pagat:**

**Për vitin 2023**, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 2 datë 02.03.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 279/1 datë 24.03.2023. Struktura Organizative është miratuar me Urdhërin nr. 80, datë 23.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë. Nëpunësit e Bashkisë Finiq i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ndërsa punonjësit administrativë dhe të terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Në Rregulloren e Brendshme të institucionit, nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të punonjësve të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative është paraqitur në Aneksin PF35, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku u konstatua se për vitin 2023 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil, realizimi i strukturës është në masën 60% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune, realizimi i strukturës është në masën 88%. Në total realizimi i strukturës është në masën 85%.

Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative të Bashkisë Finiq, u konstatua se në total struktura përbëhet nga 58 punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Shërbimin Civil dhe 147 punonjës me Kodin e Punës. Në strukturën e punonjësve civilë janë bashkuar edhe 13 punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kodin e Punës. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se vendet vakante të cilat janë hapur për shërbimin civil nuk janë plotësuar si pasojë e mosaplikimit nga persona të interesuar.

Listëpagesat përfshijnë pagën e grupit (klasifikimin e diplomës së nivelit të dytë në master shkencor ose profesional sipas rastit), pagën për funksion (niveli i klasifikuar), raportet mjekësore të paguara nga punëmarrësi, shtesa vjetërsi (klasifikimi në vit, përqindje dhe në vlerë), paga bruto, ndalesat (sipas rastit, pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore 9.5%, pagesat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore 1.7% tatimi mbi pagën). Listëprezencat janë hartuar sipas ditëve gjithsej të punës për çdo punonjës. Paga e aplikuar minimale dhe paga maksimale është në përputhje me VKM nr. 158, datë 12.03.2022, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, indryshuar, VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për nivelin e pagave për sektorin mbështetës”, VKM nr. 325, datë 31.05.2023, “Për nivelin e pagave të Gjendjes Civile” dhe VKM nr. 240, datë 20.04.2023 “Për nivelin e pagave të sektorit të MZSH”. Për sa i përket shpërblimeve për orët jashtë orarit të punës, janë aplikuar vetëm për punonjësit e MZSH-së (punonjës zjarrfikës), ndërsa për punonjësit e tjerë të institucionit nuk ka, për shkak



se nuk janë shfrytëzuar orët jashtë orarit zyrtar, pasi punonjësit i përmbahen 40 orëve në javë, sipas orarit të shpallur në rregulloren e brendshme të institucionit.

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit, u konstatua se për nëntë punonjës të emëruar përpara periudhës objekt auditimi, të cilët rregullojnë marrëdhëniet punës me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, arsimi i tyre nuk përputhet me kriteret e pozicionit të punës. Të dhënat në mënyrë të detajuar janë paraqitur në Aneksin PF36, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se një pjesë e punonjësve të cilët janë emëruar në pozicionet e shërbimit civil, nuk janë marë me procedurë konkurimi, por trajtohen me kod pune dhe janë në pritje për zhvillimin e procedurave për përfitim e Statusit të nëpunësit Civil.

#### **Veprimet me arkë:**

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Finiq, u konstatua se pagesat e taksave dhe tarifave vendore në NjA bëhen përgjithësisht nëpërmjet arkës.

Ka gjithsej 5 punonjës në Arkë. Mandat arkëtimet merren me proces-verbal nga Drejtoria e Financës, janë me numër serial, të sekretuara nga bashkia dhe blihen në Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë. Mandat arkëtimet nënshkruhen në Njësitë Administrative nga specialisti i tatimeve dhe nga arkëtari, kurse në qendër nënshkruhen nga Nëpunësi Zbatues dhe arkëtari.

Mandat pagesat priten vetëm për derdhjen në bankë dhe nënshkruhen nga kryetari i bashkisë, drejtori i financës dhe arkëtari. Të ardhurat derdhen në arkë në bazë të faturës për arkëtim që jepet nga Drejtoria e Tatimeve dhe sipas vlerave derdhen në Bankë me faturë për arkëtim e bërë nga drejtoria e financës, (përmbledhese), për çdo derdhje.

Çdo fillim të muajit pasardhës merret aktrakordimi me Degën e Thesarit Delvinë për vlerat analitike dhe përmbledhësja për çdo NjA dhe bashkinë në total. Kuadrimet bëhen nga specialistja në drejtorinë e financës, specialisti në drejtorinë e të ardhurave dhe specialisti përkatës në çdo NjA.

Çdo NjA dërgon në fund të muajit me shkresë ose me e-mail ditarin e arkës, ku dhe bëhet ditar përmbledhës nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe me të dhënat për çdo analizë, i përcillet informacion kryetarit dhe bëhet kuadrimi mujor me Degën e Thesarit Delvinë. Të dhënat e arkës për vitin 2023, në mënyrë të detajuar janë paraqitur në Aneksin PF37, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. R.Ç. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. L.M. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit nuk u paraqitën observacione nga Bashkia Finiq.

#### **2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

##### **2.4.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.**

##### **2.4.2. Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.**

##### **2.4.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi si më poshtë:

Me shkresën nr. 312/11 prot., datë 18.07.2023, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Finiq, sipas Programit të Auditimit nr. 312/1 prot. datë 19.04.2023.

- Bashkia Finiq nuk është shprehur për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të lëna, nuk ka hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, me persona përgjegjës” dhe nuk ka kthyer përgjigje në KLSH brenda 20 ditësh, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15,

shkronja j).

- Bashkia Finiq nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak dhe nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2 dhe Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, “Auditimi i jashtëm”, pika 5.

**a. Nga 26 masa organizative**, janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa, janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk janë zbatuar 14 masa.

**b. Nga 2 masa për shpërblim dëmi**, janë të dyja në proces zbatimi.

**c. Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike**, të dyja masat nuk janë zbatuar.

**d. Nga 7 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)**, 4 masa janë në proces zbatimi dhe 3 masa janë të pazbatuara.

**e. Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Finiq**, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Finiq nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e Auditimit të mëparshëm, pra rekomandimi është i pazbatuar.

Nga masat e lëna, pjesë e tyre ishin edhe kërkimi i masave të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 689/7 prot., datë 01.11.2022, konkretisht 10 masa organizative të pazbatuara, 6 masa për mungesë të ardhurash, të cilat janë në proces zbatimi, duke mbetur për arkëtim vlera 182,052 mijë lekë, si dhe 4 masa disiplinore, për të cilat për të cilat rikërkojmë zbatimin e tyre dhe për masat në proces zbatimi rikërkojmë përsheptimin e zbatimit të tyre.

Në mënyrë të detajuar, nga auditimi rezultoi si vijon:

## **A. Masa organizative**

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve;
- Të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS);
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të caktojë koordinatorin e riskut.

**Statusi: I zbatuar pjesërisht**

- Kodi i Etikës është miratuar me urdhërin e titullarit nr. 68, datë 11.03.2021;
- GMS është ngritur me Vendimin nr. 17, me nr. 3287/1 prot., datë 27.12.2022;
- Koordinator i riskut është caktuar z. V.X..

**2.1. Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Finiq të marrë masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

**Statusi: I zbatuar**

Plani i auditimit vjetor është hartuar me shkresën nr. 2803 prot., datë 19.10.2022 “Për miratimin e planit vjetor të auditimit për vitin 2023 dhe planit strategjik 2023-2025”.

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa që projektvendimi dhe relacioni për buxhetin vjetor të dërgohet për miratim pranë Këshillit Bashkiak brenda afateve ligjore.

**Statusi: I pazbatuar**

Nga auditimi i buxhetit të vitit 2023, u konstatua se relacioni për buxhetin e vitit 2023 nuk është paraqitur në afat për miratim pranë Këshillit Bashkiak.

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa që në hartimin e buxhetit të vitit pasardhës të mbahet në konsideratë shuma totale e detyrimeve të papaguara nga viti i mëparshëm me qëllim shmangien e pasojave financiare më tepër se vlera e detyrimit.

**Statusi: I pazbatuar**

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Finiq, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

**Statusi: I zbatuar**

Të ardhurat për vitin 2023 janë realizuar 96.18% ose 88,113 mijë lekë nga 91,607 mijë lekë të parashikuara.

**6.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Finiq dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

**Statusi: Në proces zbatimi**

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023, u konstatua se nga Drejtoria e Financës janë marrë disa masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Finiq dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke ulur nivelin e detyrimeve të prapambetura.

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Prokurimit Publik, Bashkia Finiq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

**Statusi: I pazbatuar**

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit Zhvillim Territorit Bashkia Finiq gjatë dhënies së lejeve të ndërtimit të marrë masa për:

- Respektimin e Planit të Përgjithshëm Vendore dhe Rregulloren Vendore të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.2, datë 10.02.2021.
- Respektimin e lejuar të përdorimit të tokës sipas legjislacionit në fuqi.
- Respektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.

- Respektimin e intensitetit të ndërtimit në zbatim të planit të përgjithshëm vendore.

**Statusi: I pazbatuar**

**9.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës të merren masa të menjëhershme për sistemimin dhe kontabilizimin e vlerës 4,309,706 lekë në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, e cila ka të bëjë me parregullsinë e nxjerrjes jashtë kontabilitetit të aktiveve të cilat ende nuk kanë marrë miratimin përkatës nga strukturat drejtuese të institucionit për asgjësimin e tyre.

**Statusi: Në proces zbatimi**

Nga auditimi u konstatua se rekomandimi është në proces zbatimi, pasi nxjerrja e aktiveve jashtë kontabilitetit është miratuar në KB, aktivet e nxjerra jashtë përdirimit janë grumbulluar në ambientet përkatëse por nuk është realizuar asgjësimi i tyre.

**10.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës të analizohet vlera 7,603,684 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar së diferencës të ndryshimit të gjendjes së inventarit, sistemi të kryhet sipas trajtimit kontabël kalimin e vlerës nga llogaria 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

**Statusi: I zbatuar**

Nga auditimi u konstatua se shuma dhe llogaritë në fjalë janë sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2023.

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**Statusi: I zbatuar pjesërisht**

Nga auditimi u konstatua se rekomandimi është zbatuar pjesërisht, pasi vetëm një pjesë e aktiveve është sistemuar duke u paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2023.

**11.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 3,369,024 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

**Statusi: I zbatuar pjesërisht**

Nga auditimi u konstatua se rekomandimi është zbatuar pjesërisht, pasi vetëm një pjesë e zërave të kësaj llogarie është sistemuar duke u paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2023.

**12.1. Rekomandimi:** Bashkia Finiq të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

**Statusi: Në proces zbatimi**

Është ngritur grupi i punës për regjistrimin e pronave të Bashkisë Finiq.

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**Statusi: I pazbatuar**

Është dërguar shkresë me nr. 1224 prot., datë 08.06.2023 Degës së Thesarit Sarandë dhe Delvinë për inventaret analitikë të dorëzuar në momentin e krijimit të Bashkisë dhe përgjigjia me shkresën nr. 218/1 datë 19.06.2023 nga Dega e Thesarit Sarandë, është se nuk dispononin inventar analitik të aseteve.

**14.1 Rekomandimi:** Bashkia Finiq, Drejtoria e Financës të marrin masa për hartimin e regjistrimit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirëmenaxhimin e tyre.

**Statusi: I pazbatuar**

**15.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT", deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

**Statusi: I pazbatuar**

Investimet të llogaria 231 kanë përfunduar si dhe kanë kaluar në llogari të Ujësjetës Rajonal Sarandë.

**16.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria e Financës të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të palikuiduara në vlerën totale 41,559,983 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

**Statusi: Në proces zbatimi**

Nga auditimi u konstatua se vlera e faturave të palikuiduara është ulur.

**17.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Kombëtare dhe Administrative të marrë masa për kalimin e fondeve të secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimit të kryer për periudhën e garancisë.

**Statusi: Në proces zbatimi**

Nga auditimi u konstatua se janë njoftuar OE dhe ata që kanë paraqitur dokumentacion të plotë janë paguar.

**18.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës të analizohet vlera 3,376,449 lekë e cila ka të bëjë me mos kuadrimit të diferencës ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sistemimi të kryhet sipas trajtimit kontabël në llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor".

**Statusi: I zbatuar**

Nga auditimi u konstatua se rekomandimi është zbatuar dhe rregullimet përkatëse janë paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2023.

**19.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria Ekonomike të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020, "Për prokurimin publik", për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

**Statusi: I pazbatuar**

**20.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për:

- Hartimin e rregullave të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

- Emërimet e nëpunësve civilë të kryhen në zbatim të kriterëve të pozicionit të punës duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

- Shpalljen e pozicioneve të punës në strukturën e IMTV për punësimin e punonjësve të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Statusi: I pazbatuar**

**21.1. Rekomandimi:** Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq të marrë masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të ekzekutojë vendimet e marra në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Në rast të pamundësisë së vendimeve të prishjes të kërkohet bashkëpunimi me IKMT qarku Vlorë për ekzekutimin e vendimeve të prishjeve.

**Statusi: I pazbatuar**

**22.1. Rekomandimi:** Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq të marrë masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi. Gjithashtu për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi, IVMT të verifikojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit deri në përfundimin e punimeve dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

**Statusi: I pazbatuar**

**23.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa të menjëhershme për vlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kërkesave teknike apo dhe dhënien me qera të sipërfaqeve kullosore.

**Statusi: I pazbatuar**

**27.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Bujqësisë në Bashkinë Finiq të analizojë problemet e konstatuara në lidhje me burimet ujore që disponon bashkia, për të ardhur në ndihmë fermerëve, kjo për evidentimin dhe dokumentimin e sipërfaqeve të mbjella sipas kulturave përkatëse, që u kryhet shërbimi i vaditjes dhe zbatimi i tarifave për çdo shërbim të realizuar, duke kryer monitorimet përkatëse, këto në zbatim të kërkesave të ligjit 24/2017, datë 09/03/2017 “*Mbi administrimin e ujitjes dhe të kullimit*”, Manualit të dërguar nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit në MBZHRAU “*Për funksionet e ujitjes dhe kullimit të transferuara te bashkitë*”, si dhe paketës fiskale të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë.

**Statusi: I pazbatuar**

**28. Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, rezultoi si më poshtë:

KLSH-ja ka dërguar në Bashkinë Finiq rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 689/7 prot, datë 01/11/2022. Nga Bashkia Finiq për zbatimin e rekomandimeve të KLSH **nuk ka kthyer përgjigje as në afatin e 20 ditëve dhe as në aftin e 6 mujorit**, në kundërshtim me nenet 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

Nga Bashkia Finiq nuk është hartuar “*Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve*”, si dhe nuk është raportuar në Këshillin Bashkiak, mbi rezultatet e auditimit të kryera nga KLSH dhe marrjen e masa pre zbatimin e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27/04/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, pika 5 e nenit 50-Auditimi i jashtëm.

**a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 15 masa organizative, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk është zbatuar 10 masa, konkretisht nuk janë zbatuar:**

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë publike. Të hartohen rregulla për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik. Të hartohet strategjia e riskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Finiq të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të veta si: llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, 214 “*Instalime teknike*, duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre Aseteve.

Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e më parë (vlera 30,809,350 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas

kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Delvinë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**7.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq nëpërmjet personave përgjegjës, të marrë masa të menjëhershme, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtori Sarandë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e të Ardhurave Bashkia Finiq, të marrë masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

**9.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Finiq, të marrë masa si vijon:

- Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe për çdo program.

- Planifikimin e procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (*faturave të palikujduara*), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbime/ investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Finiq.

- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- Të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.

- Të monitorojë dhe miratojë raportet 4 mujore e buxhetit.

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Kontratave të përcjellë pranë Drejtorive Rajonale Tatimore përkatëse, të gjitha rastet kur faturat e shitjeve janë paraqitur me vonesë dhe pa shkaqe nga momenti i kryerjes së punimeve/shërbimit, me qëllim vlerësimin e mos deklaramit në afat për TVSH në shitje.

**11.1. Rekomandimi:** Bashkia Finiq nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për menaxhimin e aseteve, identifikimin e gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasitet për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë dhe plotësimin e nevojave për komunitetin, por dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre procedura.

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përsheptimin e zbatimit për ato që janë në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1116/8 datë 01.11.2021 “Për

zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

**b. Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar 6 masa me vlerë 200,267 mijë lekë, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 6 masa, ku nga vlera e rekomanduar prej 200,267 mijë lekë është arkëtuar vlera 18,215 mijë lekë, duke mbetur per arkëtim vlera 182,052 mijë lekë, konkretisht nuk janë zbatuar:**

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **5,300,000 lekë** nga **3 subjektet**, respektivisht;

- vlera **1,100,000 lekë** nga subjekti “**T.V.**” ShPK
- vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti “**G.C.G.**” ShPK;
- vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti “**K.**” ShPK;
- vlera **2,200,000 lekë** nga subjekti “**B.O.**” ShPK

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave Bashkia Finiq, të marrin të gjitha masat dhe të mos lejojnë lidhjen e kontratave të shërbimi/investimit me subjektet fituese pa likujduar detyrimet për taksat vendore sipas paketave fiskale.

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **108,000 lekë**, respektivisht:

- vlera **54,000 lekë**, ndaj subjektit “**N.**”.
- vlera **54,000 lekë**, ndaj subjekti “**E. (A.G.)**”.

**d. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej 4 masa të pranuar plotësisht, rezulton se nuk është zbatuar asnjë masë, konkretisht:**

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Finiq, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale, respektivisht:

- 1. Znj. L.M.**, me detyrë Drejtore e Financës.
- 2. Z. I.N.**, me detyrë Drejtor i Ardhurave
- 3. Z. T.Z.** me detyrë P/ Ardhura Vendore
- 4. Z. R.B.**, me detyrë P/ Ardhura Vendore

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 116-120, të Projekt Raport Auditimit).

**28.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për përshpejtimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi dhe të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 689/7 datë 01.11.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”.

**Statusi: I pazbatuar**

## **B. Masa për shpërblim dëmi:**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike bashkia Finiq të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **561,540 lekë nga shoqëria ‘N.’** shpk, për mos zbatim të kontratës nr. 1736, datë 4.7.2022.

**Statusi: Në proces zbatimi**



Është njoftuar OE N. ShPK me shkresën nr. 656 prot., datë 13.03.2024, por nuk ka kthyer përgjigje.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve për menaxhimin e kontratave të analizojë dosjen e procedurës me objekt “*Mirëmbajtje e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës*”, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 68, datë 19.4.2022 (mbi afatin e punimeve), dhe në rast të mungesës së dokumentacionit mbështetës të marrë masa në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Finiq duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **287,831 lekë nga subjekti “A.C.” shpk.**

**Statusi: Në proces zbatimi**

Është njoftuar OE A.C. ShPK me shkresën nr. 661 prot., datë 13.03.2024, por nuk ka kthyer përgjigje.

**C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike**

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Finiq, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Statusi: I pazbatuar**

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialit të fushës ose me subjekte të liçencuara për saktësinë e llogaritjes së fondit limit në përputhje me çmimet e manualit për të shmangur mos efektivitetin e fondeve të prokuruar për vlerën 2,290,080 lekë.

**Statusi: I pazbatuar**

**D. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për bashkërendimin e punës me të gjithë sektorët e tjerë të cilët funksionojnë në planifikimin e të ardhurave, duke përcaktuar qarte vlerat e të ardhurave që duhet planifikuar sipas burimit të krijimit të tyre. Në planifikim buxhetor për vazhdimësinë të pasqyrohen qarte vlera e debisë së mbartur si dhe detyrimi vjetor që është pasqyruar në regjistrin e të ardhurave. Gjithashtu nga ana e Drejtorisë të të ardhurave të Bashkisë të merren masat e menjëhershme për vlerësimin e detyrimeve të subjekteve që merren me tregtinë e hidrokarbureve, duke arkëtuar detyrimin prej 5,600,000 lekë, në rast të kundërt të vlerësohen kërkesat e ligjit deri në pezullimin e aktivitetit.

**Statusi: Në proces zbatimi**

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2023 është rritur realizimi i të ardhurave në masën 96.1%.

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Finiq, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **213,212,631 lekë.**

**Statusi: I pazbatuar**

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masat e menjëhershme për auditimin e statusit të këtyre subjekteve në teren, si dhe të kërkohet zbatimi i procedurave për përfitimin e këtij statusi. Po kështu të kërkohet menjëherë arkëtimi i detyrimeve të pa likuiduara nga ana e këtyre subjekteve që është në vlerën **1,757,602 lekë.**

**Statusi: I pazbatuar**

**3.1. Rekomandimi:** Njësia e Ujitjes dhe Kullimit pranë Bashkisë Finiq të bëjë monitorimin e gjithë sipërfaqes së mbjellë për çdo kulturë, të monitorojë kërkesat për vaditje dhe të vlerësojë

detyrimin sipas kërkesave të ligjit nr. 24/2017, date 09/03/2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe të kullimit”.

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq në bashkëpunim me Njësinë e Ujitjes dhe Kullimit, të marrë masa të menjëhershme të bëjë njoftimin te gjithë fermerëve mbi detyrimet që kanë pa likuiduar për arkëtimin e detyrimeve të mbartura dhe të pa arkëtuara deri në fund të vitit 2022, për vlerën **3,465,443 lekë**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

Nga auditimi u konstatua se janë dërguar njoftimet për mbledhjen e detyrimeve ndaj subjekteve me vlerën e mësipërme të debisë.

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës së detyrimit prej **3,548,500 lekë** nga subjektet përkatës sipas trajtimit analitik të bërë në kapitullin e auditimit të kontratave të lidhura për dhënien me qira të sipërfaqeve kullosore.

**Statusi: I pazbatuar**

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës debitore prej **703,400 lekë** nga **3 subjekte debitore**, përkatësisht, nga z. A.I. për shumën **146,000 lekë**, z. S.S. për shumën **273,600 lekë** dhe z. I.D. për shumën **283,800 lekë**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

Nga Bashkia Finiq janë dërguar njoftimet për mbledhjen me forcë të detyrimeve ndaj subjekteve me vlerën e mësipërme të debisë.

S.S. në proces arkëtimi, A.B. pa shpresë arkëtimi, I.D. nuk ka kontratë me Bashkinë Finiq.

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës debitore prej **16,906,142 lekë** nga **41 subjektet** që rezultojnë debitore nga mospagimi i detyrimit të marrjes me qira të tokës bujqësore të pandarë.

**Statusi: Në proces zbatimi**

Nga Bashkia Finiq janë dërguar njoftimet për mbledhjen me forcë të detyrimeve ndaj subjekteve me vlerën më të madhe debitore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi z. K.K., ish kryetar i Bashkisë Finiq deri në datën 26.06.2023; z. R.Ç., me detyrë Kryetar i Bashkisë Finiq; znj. L.M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, z. I.N. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave; znj. I.E., me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe z. Z.K., me detyrë Përgjegjës Sektori i Pyjeve dhe Kullotave.

## **2.5. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit**

Në zbatim të autorizimit nr. 433/2 prot., datë 03.06.2024, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për verifikimin e ankesave të z. F.S., administruar në KLSH me nr. 698 prot., datë 20.05.2024 dhe z. T.E., administruar në KLSH me nr. 730 prot., datë 29.05.2024, u krye verifikimi në Institucionin e Bashkisë Finiq, si më poshtë:

- Objekti i të dy ankesave është problematika që lidhet me situatën ndërtimore, duke denoncuar K/inspektorin e IMT Finiq, znj. S.S. dhe K/inspektorin e Policisë Bashkiake, z. L.H.. Sipas ankuesit, z. N.V. ka uzurpuar një truall/rrugë në mënyrë antiligjore, duke bllokuar lëvizjen e komunitetit dhe sjellë vështirësi në jetesën e përditshme, deri në pengesën e ndërhyrjes së MZSh-së në rast situatë, e cila mund të sjellë pasoja. Për këtë situatë, qëndrimi i IMT-së dhe Policisë Bashkiake Finiq, gjatë kësaj periudhe është në shkelje të plotë të ligjit. Lidhur me K/inspektorin e Policisë Bashkiake, z. L.H., ankuesi sqaron se nuk përmbush kriteret ligjore për pozicionin e punës dhe ndërkohë rezultojnë edhe i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me 6 muaj burg për falsifikim dokumentesh,

vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër. Pretendimet lidhur me këtë punonjës, i argumenton me Vendimin Gjyqësor nr. 23-2016-989 (137 Vendimi, datë 16.05.2016 dhe shënimin sipas të cilit mbi këtë vendim është bërë ankim nga i pandehuri L.H. në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila me Vendimin nr. 20-2016-843/200 datë 28.07.2006 ka vendosur lënien në fuqi, ku në aplikim të nenit 59 K. Penal urdhërohet vënia në shërbim prove për një periudhë prej 3 vitesh.

- Ankuesi, sqaron gjithashtu se Kryetari i Bashkisë ka punësuar në bashki bashkëshorten e N.V.s, shtetasen L., që është uzurpuesi i rrugës.

- Ankuesi sqaron se Kryetari i Bashkisë z. R.Ç., parkimin e Syrit të Kaltër të dhënë për menaxhim nga Ministria e Turizmit, ia ka dhënë për menaxhim kushëririt të tij, i cili s'ka lidhje me këtë punë, pasi ky është pronar baxhoje në Vrion të Bashkisë Finiq.

**1.** Grupi i auditimit të KLSH-së, kërkoi informacion nga K/inspektori i IMT, znj. S.S., e cila vuri në dispozicion dokumentet që dispononte lidhur me situatën e bllokimit të rrugës nga shtetasi N.V., si dhe dosjen e kësaj punonjëseje nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Znj. S.S., është emëruar në detyrën e Inspektore pranë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, me urdhërin nr. 80, datë 18.07.2016 të Kryetarit të Bashkisë Finiq, z. L.K..

Me urdhërin nr. 31, datë 27.02.2018, kalon me detyrë nga inspektore në Kryeinspektore e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.

Me urdhërin nr. 160, datë 07.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë z. K.K., kalon me detyrë nga përgjegjëse pranë IMT-së, në detyrën Specialiste për Urbanistikën Ligjore pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Për periudhën nga 07.11.2022 deri më datë 04.01.2023, vendi i K/inspektorit ka mbetur vakant, deri në emërimin e z. P.S. sipas urdhërit me nr. 7, datë 04.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Finiq.

Me urdhërin nr. 83, datë 23.08.2023, Kryetari i Bashkisë Finiq, z. R.Ç., e rikthen në detyrën e K/inspektore pranë IMT znj. S.S., detyrë të cilën e kryen aktualisht.

- Lidhur me arsimin, K/inspektori S.S., rezulton me arsim në fushën e drejtësisë, profil i cili është në përputhje me përcaktimet e nenit 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”.

**2.** Për situatën e bllokimit të rrugës, nga IMT Bashkia Finiq është mbajtur Procesverbali nr. 2885 prot., datë 31.10.2022, i mbajtur nga znj. S.S. dhe z. I.B. Sipas këtij akti, gjatë kontrollit për konfliktin në fshatin Kostar, është pasqyruar fakti në lidhje me thurjen me gardh të bërë nga z. N.V.. Sipas këtij procesverbali, u konstatuan punime për ndërtimin e një gardhi dhe iu kërkua dokumentacioni tekniko ligjor. Ky procesverbal është mbajtur me përfaqësuesit e IMT-së, Policisë Bashkiake, Policisë dhe palët në konflikt, N.V. dhe T.E., të cilët kanë firmosur procesverbalin. Në vijim është mbajtur një Akt Kontrolli pa nr., datë 17.11.2022 nga policia bashkiake, ku paraqitet situata sipas së cilës po rrethohej një pronë me rretë teli nga shtetasi N.V. dhe e kapur me beton. Ky shtetas nuk kishte asnjë dokumentacion.

Informacioni i është dërguar me shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, Komisarariatit të Policisë Sarandë.

- Me procesverbalin nr. 263 prot., datë 31.01.2024 të mbajtur nga IMT, është pasqyruar situata në vijim, sipas së cilës në lidhje me konfliktin e mbartur, iu dha zgjidhja. Rruga për të shkuar z. T.E. etj., do kalojë midis pronës së shtetasit Dh. E. dhe N.V., deri në momentin e hapjes së rrugës. N.V. do prishë gardhin në akset që janë kthesat, për të kaluar lirshëm makinat dhe zjarrfikësja. Sipas këtij akti, i cili është përpiluar në formën e marrëveshjes, palët bien dakord të firmosin këtë relacion.


- Është pasqyruar procesverbali tjetër që mban datën 01.02.2024 nga K/inspektori, i cili paraqet faktin se pas rënies dakord për prishjen e gardhit dhe hapjes së rrugës, shtetasi N.V., ka refuzuar të lejojë përfaqësuesit e IMT-së dhe policisë bashkiake për të kryer ekzekutimin e prishjes së

rënë dakord, duke kërkuar piketimin e rrugëve dhe dhënien e zgjidhjes së rrugës për dy familjet e tjera që kanë banesat aty.

- Është mbajtur një akt konstatimi me nr. 1195 prot., datë 20.05.2024 nga policia bashkiake, sipas të cilit në fshatin Kostar, z. N.V. ka vendosur një portë metalike me dy fletë me përmasa 1.7 x 1.5 metër lartësi, të cilat i kishte betonuar. Duke qenë se është vendosur pa leje, nga Policia Bashkiake u vendos heqja e portës dhe lënia e lirë e rrugës, pasi N.V. nuk dispononte titull pronësie.



*Foto e rrugës së bllokuar, e mbajtur në terren.*



*Foto e shtyllave të hekurit dhe rrethimit*

**3.** Lidhur me pretendimet për K/inspektorin e Policisë Bashkiake, z. L.H., u kërkua dosja e këtij punonjësi dhe dokumentacioni që disponohej. Sipas dokumenteve në dosje, rezultoi se L.H. ka paraqitur kërkesë për punë drejtuar Bashkisë Finiq. Ka filluar punë pranë Bashkisë Finiq sipas urdhërit të Kryetarit z. L.K. me nr. 126, datë 19.12.2017, ku emërohet polic i Policisë Bashkiake. Ka paraqitur në dosje vërtetimet e nevojshme të marra nga Prokuroria pranë Shkallës së Parë Sarandë me nr. 2161 prot., datë 20.06.2017, sipas së cilës ky shtetas me banim në Finiq, nuk është në ndjekje penale nga kjo Prokurori, nga data 01.01.2017 deri sot me datë 20.06.2017. Është lëshuar vërtetimi me nr. 606 prot., datë 20.06.2017 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, sipas të cilit ky shtetas sipas regjistrave të kësaj gjykate, nuk rezultoi të ketë proces gjyqësor (civil/penal), nga data 01.01.2017 deri më sot.

Është paraqitur Vërtetimi i Gjendjes Gjyqësore (dëshmia e penalitetit) me nr. 1 prot., datë 19.06.2017 e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas të cilit ky shtetas rezultoi **i padënuar**.

Në dosjes e punonjësit gjendet dokumenti i vërtetimit të notave të shkollës së mesme, vërtetim që mban nr. 261 prot., datë 29.08.1988.

Me urdhër të Kryetarit z. R.Ç. me nr. 58, datë 03.07.2023, urdhërohet kalimi i këtij shtetasi nga polic bashkie, në K/inspektor të Policisë Bashkiake. Lidhur me arsimimin e tij, rezultoi se nuk plotëson kushtet e nevojshme sipas nenit 3 të Ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për policinë bashkiake”, i cili përcakton se K/inspektori duhet të jetë i diplomuar në Akademinë e Policisë.

**4.** Lidhur me punësimin e shtetases L.V., u verifikua dosja e punonjëses, ku rezultoi se kjo shtetase ka paraqitur kërkesën drejtuar Bashkisë Finiq për punësimin e saj. Me urdhërin nr. 8, datë 09.01.2024 të titullarit, kjo shtetase është emëruar në pozicionin e Inspektore pranë

Drejtorisë së të Ardhurave dhe Pronave Publike. Në dosje ndodhet dokumentacioni i nevojshëm, ku kjo shtetase ka shkollimin e lartë dhe dokumente të tjera të nevojshme për dosjen e punës.

5. Lidhur me situatën e parkimin, rezulton se ajo funksionon me 2 punonjës me kontratë shërbimi. Sa më sipër rezulton se parkimi menaxhohet nga bashkia, e cila ka emetuar bileta të vulosura me numër serial, të cilat dorëzohen me procesverbal. Të ardhurat nga parkimi për vitin 2023 rezultojnë në vlerën 9,443 mijë lekë ndërsa për periudhën 17 prill-31 maj 2024 në vlerën 1,183 mijë lekë. Siç rezulton nga informacioni i administruar nga financa, Parkimi i Syrit të Kaltër ka sjellë të ardhura për buxhetin e kësaj bashkie.

#### **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

**Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk funksionojnë dhe nuk kuptohen mjaftueshëm përgjatë gjithë strukturave të njësisë, konkretisht:

- Rregullorja e brendshme e Bashkisë Finiq nuk është hartuar në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi;
- Bashkia Finiq nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit dhe nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve;
- Struktura Organizative e miratuar nuk është e shoqëruar me organigramën përkatëse.
- Bashkia Finiq nuk ka respektuar përcaktimet ligjore për rekrutimin e punonjësve sipas procedurave të konkurrimit dhe në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni. Nuk ka nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil;
- Bashkia Finiq nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, përfshirë vlerësimin e riskut të mashtrimit,
- Në Bashkinë Finiq, Drejtoria Ekonomike dhe e Buxhetit për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program kontabiliteti.
- Bashkia Finiq nuk respekton legjisllacionin për trajtimin e kërkesave/ankesave dhe praktikat shkresore, marrëdhëniet me publikun. Vërtetimet e lëshuara përgatiten dhe protokollohen pa u depozituar më parë në protokoll një kërkesë me shkrim nga qytetarët, si dhe nuk kryhet monitorimi i respektimit të afateve për trajtimin e kërkesave dhe ankesave;
- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të institucionit në tërësi dhe të njësisë të varësisë të tij.
- Mungojnë raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.
- Në Bashkinë Finiq mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.
- Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 “Për Miratimin e Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 22-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për:

- Hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen dhe vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit;
- Rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrin të Riskut;
- Ngritjen e strukturës së koordinatorit dhe grupit të menaxhimit të riskut;
- Të garantuar se njoftimi/shpallja e vendeve të lira të punës, do të dërgohet zyrtarisht për t'u publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së NjAB për vitin 2023, u konstatua se:

- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.
- Inventarët e dosjeve koherente të auditimit nuk janë në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Formatin Standard nr. 1.
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.
- Raportimi mbi aktivitetin vjetor të NjAB, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së miratuar, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;
- Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësive vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të NjAB;
- Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, Pika 4.1.12., Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”;
- Në planin vjetor të auditimit, përgjithësisht janë përfshirë për auditim sistemet me risk të mesëm dhe të lartë por nuk është vlerësuar si duhet auditimi i disa fushave me risk, konkretisht nuk janë analizuar dhe nuk është hartuar program i veçantë mbi prokurimet publike. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”; UMF nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, Kapitulli IV, pika 4.1.1 “Planifikimi i një angazhimi auditimi”, Kapitulli IV, pika 4.1.12 Hapi 11, Kapitulli VII, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet vetë nga NjAB”.  
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 22-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Të merren masa për të ngritur Komitetin e Auditimit, me qëllim rritjen e cilësisë të punës audituese.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës në lidhje me respektimin e afatit 30-ditor për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, u konstatua se nuk janë respektuar pagesat për vlerën totale 31,995,678 lekë, nga e cila vlera 25,278,679 lekë janë shpenzime që i përkasin llogarisë 602 dhe vlera 6,716,999 lekë janë shpenzime që i përkasin

llogarisë 230/231.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 11 pika 1, neni 54, neni 61, Ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, UMFE nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe UMFE nr. 37 datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 27-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura, Kryetari i Bashkisë Finiq, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrin masa për likuidimin e faturave për blerje mallrash dhe/ose shërbimesh brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Taksave nuk disponon dokumentacionin përkatës mbi bazën referuese në llogaritjen e detyrimeve sipas llojit të taksës apo tarifës vendore, për çdo subjekt familjar.

Dosjet personale të hapura për çdo biznes kanë mangësi të të dhënave dhe nga vlerësimi i tyre rezultoi se nga 158 subjekte fizike që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Finiq, janë regjistruar pranë QKB dhe disponojnë NIPT 133 subjekte fizike, ndërsa 25 subjekte ushtrojnë aktivitet, paguajnë taksat dhe tarifave vendore, por nuk figurojnë të pajisur me NUIS nga QKB. Gjatë vitit 2023, rezultoi se kanë mbyllur aktivitetin 20 subjekte, të cilat figurojnë të çregjistruara në regjistrin e të ardhurave të bashkisë, por nuk disponohet asnjë lloj dokumentacioni që të faktojë likuidimin e detyrimeve deri në momentin e shkëputjes apo edhe shkresa zyrtare që këto subjekte kanë paraqitur për mbyllje të aktivitetit. Nga vlerësimi i kryer, rezultoi se 4 nga subjektet e mbyllura, pavarësisht mangësive dokumentare në dosjet e subjekteve, figurojnë debitorë pranë Bashkisë Finiq për moslikuidim të taksave dhe tarifave vendore deri në fund të vitit 2022, për vlerën prej 1,757,602 lekë.

Në planifikimin vjetor për biznesin, figuron vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022, si dhe detyrimet e vitit 2023 për të gjitha bizneset, por detyrimi i mbartur në vite nuk figuron i pasqyruar sipas llojit të detyrimit por është i evidentuar në total.

Në regjistrin e bizneseve është përfshirë debia e mbartur, por kjo debi nuk del sipas llojit të detyrimit për çdo zë taksë apo tarifë vendore.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 7, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 2, pika 13 dhe 16, nenet 28-40, neni 42, neni 43 gërma d, neni 59; VKB nr. 47 datë 29.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Finiq”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 27-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masat si vijon:

- Të plotësojë dokumentacionin në dosjet e taksapaguesve familjarë dhe biznese, me qëllim përlllogaritjen e saktë të detyrimeve dhe shmangien e krijimit të të ardhurave të munguara;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë dhe QKB, të pajisë me NUIS të gjitha subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e saj administrativ. Gjithashtu, të bëjë në mënyrë periodike rakordimet me QKB, me qëllim evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve nga subjektet të cilat mbyllin aktivitetin;



- Me qëllim evidentimin e saktë dhe në vijimësi të detyrimeve të prapambetura, detyrimi i mbartur në vite të pasqyrohet sipas llojit të detyrimit dhe debia e mbartur në regjistrin e bizneseve të dalë sipas llojit të detyrimit për çdo zë takse apo tarife vendore.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se struktura e DTTV Bashkia Finiq nuk është plotësisht në funksion të planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. DTTV Bashkia Finiq organizohet në nivel drejtorie dhe ka në përbërjen e saj 2 sektorë. Në strukturën e DTTV mungon “*Spektori i Menaxhimit të Borxhit tatimor*”. Menaxhimi i borxhit tatimor dhe alternimi midis vlerësimit dhe planifikimit është i nevojshëm të organizohet në nivel sektori sepse:

- Këto procese kanë natyrë të ndryshme pune, arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe ka afate të përcaktuara.

- Subjektet debitorë të prapambetur në Bashkinë Finiq kanë peshë si në numër ashtu dhe në vlerë, konkretisht vetëm për kategorinë “Biznes” debitorë të trashëguar nga viti 2022 janë 230 subjekte pra 100% e subjekteve.

- Bashkia Finiq për individët familjarë dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj (sipas kategorizimeve dhe nënkategorive për veprimtarinë që ushtrojnë etj.), ka miratuar në strukturën e paketës fiskale për vitin 2023 në total 65 taksa/tarifa vendore dhe 20 gjoba për kundërvajtje administrative. Struktura e evidencës së realizimit të të ardhurave për vitin 2023 jep informacion mbi planifikimin dhe realizimin vetëm për 18 taksa dhe tarifa vendore.

- Për disa lloje taksash dhe tarifash nuk është përcaktuar qartë struktura e ngarkuar për të bërë përlllogaritjen dhe struktura që do të ndjekë vjeljen e taksës ose tarifës përkatëse. Gjithashtu konstatohet se në disa raste për vjeljen e taksave dhe tarifave të ndryshme ngarkohen njëkohësisht më shumë se dy struktura.

- Procesi për planifikimin, përlllogaritjen e detyrimeve tatimore, ndjekjen e subjekteve debitorë për taksat dhe tarifatat vendore nuk është i saktë, pasi planifikimi për taksat dhe tarifatat vendore nuk është kryer bazuar në rakordimin midis DTTV, DRT dhe QKB për numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin që administron Bashkia Finiq, analizën e rezultatit historik, pritshmëritë e vitit korrent dhe koordinimin midis drejtorive që mbulojnë realizimin e tyre.

- Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj., në regjistrin elektronik në format EXCEL të DTTV-së nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacionin përkatës, duke ndikuar në cilësinë e të dhënave që popullojnë bazën e regjistrit elektronik të DTTV-së, në planifikim dhe në përgatitjen e evidencave të qarta sa i përket identifikimit të subjektit dhe përcaktimit të njoftim detyrimit për t’u paguar lidhur me taksat dhe tarifatat vendore.

- Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2023 nuk jep informacion të plotë mbi të gjitha taksat/tarifatat vendore dhe gjobat e aplikuara për kundërvajtjet administrative pasi drejtoritë që administrojnë taksat/tarifatat vendore nuk mbajnë regjistër për menaxhimin e të dhënave. (Vetëm DTTV administron regjistër për menaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifa vendore).

- Evidenca e realizimit të të ardhurave për vitin 2023 nuk jep informacion për 73% të taksave/tarifave vendore të miratuara në paketën fiskale për vitin 2023, në vlerë absolute 47 taksa/tarifa.

- Në DTTV nuk përcillet informacion lidhur me “*Planifikimin*” mbi realizimin e pritshëm për taksat/tarifatat vendore dhe “*Listat e Debitorëve*” nga gjithë struktura e ngarkuar për administrimin e të ardhurave, por vetëm nga DTTV për taksat/tarifatat që administron.

Sa më sipër “*Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2023*” dhe “*Vlerësimi i gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifatat vendore*” sipas strukturës së Paketës Fiskale të miratuar nuk janë të plota.

- Ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimi apo mbyllja e adresave dytësore dhe të dhënat mbi të cilat përllogariten tarifatat dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese nuk realizohen duke rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.

- Akt konstatimet nga specialistët e terrenit nuk janë të rifreskuara periodikisht (çdo vit) dhe nuk shprehin qartë objektin për të cilin është kërkuar mbajtja e këtij akt konstatimi. Në asnjë rast Akt konstatimet e mbajtura nuk japin informacion të plotë sa i përket:

- Të dhënat e nevojshme për përcaktimin e bazës së taksës nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues të njehsuar me origjinalin (llojit të aktivitetit të deklaruar/faktik nga subjekti, adresën e plotë ku ushtrohet ky aktivitet, sipërfaqen në të cilën ushtrohet aktivitet etj.);

- Mungon gjurma e auditimit mbi vlerësimin e gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifatat vendore.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 7, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 2, pika 13 dhe 16, nenet 28-40, neni 42, neni 43 gërma d, neni 59; VKB nr. 47 datë 29.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Finiq”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 27-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masat si vijon:

- Të rishikojë dhe saktësojë regjistrin e taksapaguesve kategoria biznes, duke përshtatur kategorinë/nënkategorinë me “veprimtarinë” që ushtrohet, në mënyrë që përllogaritja e detyrimeve të bëhet e saktë sipas parashikimeve në paketën fiskale. Të rishikohet paketa fiskale duke parashikuar taksa e tarifa për të gjitha kategoritë e biznesit që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë. Të rishikohet “Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave” duke parashikuar informacion të plotë mbi të gjitha taksat/tarifatat vendore sipas paketës fiskale;

- Të koordinojë punën me institucionet e ndërlidhura, me qëllim marrjen dhe dhënien e informacioneve në kohë reale për shmangien e problematikave të konstatuara;

- Të kryejë inventarizimin e të gjithë subjekteve të cilët janë objekt i taksave vendore, të plotësojë një regjistër me të dhënat përkatëse, të plotësojë dosjet e subjekteve tatimpagues me dokumente justifikuese të cilat shërbejnë për përllogaritjen e detyrimeve dhe të informojë në mënyrë kronologjike veprimtarinë e tatimpaguesit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit, u konstatua se procesi i inventarizimit përgjithësisht është kryer nga të njëjtët persona pjesëmarrës në komisionet e viteve të kaluara, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 84.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 45-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Finiq, të merren masa që në komisionet e ngritura për inventarizimin, të mos caktojë dy herë me radhë të njëjtët persona.

*Me mbylljen e PF të vitit 2024*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, është përfshirë vlera 8,030,494 lekë, e cila është e paanalizuar sipas studimeve dhe projekteve. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave të konsoliduara në Bashkinë Finiq.

Në këtë llogari është kontabilizuar edhe vlera 3,369,024 lekë kosto historike, e cila i përket 2 projekteve “Projektim rikonstrukcion rruga Dermish-Cerkovicë (viti 2017)” në vlerën 941,623

lekë dhe “Projekt rehabilitimi i kanalit Filipeu”, në vlerën 2,427,401 lekë, të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim. Për pasojë, vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë, por është mbivlerësuar për shumën 3,369,024 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II, pika 1/b dhe UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Kreu II, pika 5 dhe Aneksi 1, pika 2, klasa 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 45-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Finiq, të marrë masa për:

- Analizimin e dokumentacionit për aktivet e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, të hyra në vite duke verifikuar, saktësuar dhe analizuar vlerën 8,030,494 lekë dhe të bëjë sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në regjistrin përkatës të aktiveve/inventarin fizik;
- Të sistemojë llogarinë 202 “Studime e kërkime”, duke e pakësuar me vlerën 3,369,024 lekë dhe këtë vlerë ta shtojë në vlerën e investimeve të përfunduara.

*Me mbylljen e PF të vitit 2024*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023, rezultoi se:

- Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione”, është përfshirë vlera 99,236,804 lekë, e paanalizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendjen fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq dhe Livadhja.

- Llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota dhe plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, nuk janë të analizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku të specifikohet informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85 dhe UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme””, Kreu II, pikat 5, 36 dhe Kreu III, pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 45-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masat për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, përfshirë asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Vlerësimi i aseteve të bëhet për vlerën reale, sipas zonave kadastrale dhe të regjistrohen si pasuri e saj në AShK, dega Sarandë.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2023, rezultoi se:

- Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione”, është përfshirë vlera 99,236,804 lekë, e paanalizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq dhe Livadhja.

- Llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota dhe plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, nuk janë të analizuar në përputhje me

kërkesat e përcaktuara në UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku të specifikohet informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85 dhe UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme””, Kreu II, pikat 5, 36 dhe Kreu III, pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 45-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Finiq, të marrë masa për:

- Analizimin e dokumentacionit për aktivitetet e llogarive 212 “Ndërtime e konstruksione”, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota dhe plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, të hyra në vite duke verifikuar, saktësuar dhe analizuar vlerën dhe të bëjë sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në regjistrin përkatës të aktiveve/inventarin fizik;

- Hartimin e regjistrit të aktiveve të Bashkisë me të gjitha kërkesat e formatit të miratuar, për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

*Me mbylljen e PF të vitit 2024*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se llogaria 231, “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezultoi se për vitin 2023 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat për vlerën 23,056,648 lekë, që i përkasin llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navaricë”, me vlerë të kontraktuar 32,179,880 lekë me TVSh dhe objektit “Rikonstruksioni i rrugës Karroq”, me vlerë 9,999,347 lekë. Gjendja e kësaj llogarie duhet të ishte 42,179,227 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Aneksi 1, Klasa 23.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 45-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike, pagesat e vlerave pjesore për blerjen e aktiveve afatgjata, në mbajtjen e kontabilitetit duhet t’i evidentojë në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

*Me mbylljen e PF të vitit 2024*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se në analizën e llogarisë 466, “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Finiq, për 19 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Finiq, janë ngurtësuar fonde në vlerën 17,467,104 lekë, për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre dhe për to është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Kapitulli III, pikat 29,

30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 45-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Kombëtare dhe Administrative të marrin masa për kalimin e fondeve të secili kontraktor për objektin të cilit i ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimit të kryer.

*Menjëherë*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë, u konstatua se është zhvilluar 1 projekt për pritje-përcjellje, për të cilin nuk janë zhvilluar procedurat e prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjin nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën””, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 8, konkretisht me faturën nr. 3, datë 17.06.2023, me objekt “Aktivitet pritje përcjellje për vitin 2023”, me përfitues OE K.T., në vlerën 500,800 lekë, sipas urdhërit të shpenzimit nr. 588, datë 20.12.2023.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 45-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria Ekonomike të evidentojnë të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi dhe të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre, referuar akteve ligjore në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

Me shkresën nr. 312/11 prot., datë 18.07.2023, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Finiq, sipas Programit të Auditimit nr. 312/1 prot. datë 19.04.2023.

- Bashkia Finiq nuk është shprehur për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të lëna, nuk ka hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, me persona përgjegjës” dhe nuk ka kthyer përgjigje në KLSH brenda 20 ditësh, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja j).

- Bashkia Finiq nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak dhe nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2 dhe Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, “Auditimi i jashtëm”, pika 5.

**a. Nga 26 masa organizative,** janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa, janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk janë zbatuar 14 masa.

**b. Nga 2 masa për shpërblim dëmi,** janë të dyja në proces zbatimi.

**c. Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike,** të dyja masat nuk janë zbatuar.

**d. Nga 7 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara),** 4 masa janë në proces zbatimi dhe 3 masa janë të pazbatuara.

**e. Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Finiq**, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Kryetarit të Bashkisë Finiq nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e Auditimit të mëparshëm, pra rekomandimi është i pazbatuar.

Nga masat e lëna, pjesë e tyre ishin edhe kërkitimi i masave të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 689/7 prot., datë 01.11.2022, konkretisht 10 masa organizative të pazbatuara, 6 masa për mungesë të ardhurash, të cilat janë në proces zbatimi, duke mbetur për arkëtim vlera 182,052 mijë lekë, si dhe 4 masa disiplinore, për të cilat rikërkojmë zbatimin e tyre, ndërsa për masat në proces zbatimi rikërkojmë përsheptimin e zbatimit të tyre.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 57-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

**A.1.1. Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.**

Rekomandimet nr. 1.1, 3.1, 4.1, 6.1, 9.1, 11.1, 11.2, 12.1, 13.1, 14.1, 15.1, 16.1, 17.1, 19.1 dhe 20.1, si dhe masat për rikërimin e zbatimit të rekomandimeve sipas shkresës nr. 689/7 prot, datë 01.11.2022, respektivisht 1.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 25 (masa organizative), 7.1, 9.1, 10.1, 6.1, 28, 5.1, 7.1 (masa për mungesë të ardhurash), që i përkasin kategorive “masa organizative” dhe “mungesë të ardhurash” të cilat nuk janë zbatuar, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohen, përveç rekomandimeve nr. 7.1, 8.1, 21.1, 22.1, 23.1, 27.1, 28:

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Prokurimit Publik, Bashkia Finiq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i economicitet, efikasë dhe efektivitetit, bazuar në kriterë të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit Zhvillim Territorit Bashkia Finiq gjatë dhënies së lejeve të ndërtimit të marrë masa për:

- Respektimin e Planit të Përgjithshëm Vendore dhe Rregulloren Vendore të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.2, datë 10.02.2021.
- Respektimin e lejuar të përdorimi të tokës sipas legjislacionit në fuqi.
- Respektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.
- Respektimin e intensitetit të ndërtimit në zbatim të planit të përgjithshëm vendore.

**21.1. Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq të marrë masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të ekzekutojë vendimet e marra në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Në rast të pamundësisë së vendimeve të prishjes të kërkohet bashkëpunimi me IKMT qarku Vlorë për ekzekutimin e vendimeve të prishjeve.

**22.1. Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq të marrë masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje

ndërtimi. Gjithashtu për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi, IVMT të verifikojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit deri në përfundimin e punimeve dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

**23.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa të menjëhershme për vlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kërkesave teknike apo dhe dhënien me qera të sipërfaqeve kullosore.

**27.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Bujqësisë në Bashkinë Finiq të analizojë problemet e konstatuara në lidhje me burimet ujore që disponon bashkia, për të ardhur në ndihmë fermerëve, kjo për evidentimin dhe dokumentimin e sipërfaqeve të mbjella sipas kulturave përkatëse, që u kryhet shërbimi i vaditjes dhe zbatimi i tarifave për çdo shërbim të realizuar, duke kryer monitorimet përkatëse, këto në zbatim të kërkesave të ligjit 24/2017, datë 09/03/2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, Manualit të dërguar nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit në MBZHRAU “Për funksionet e ujitjes dhe kullimit të transferuara të bashkitë”, si dhe paketës fiskale të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë.

**11.1. Rekomandimi:** Bashkia Finiq nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për menaxhimin e aseteve, identifikimin e gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasitet për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë dhe plotësimin e nevojave për komunitetin, por dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre procedura.

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përsheptimin e zbatimit për ato që janë në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1116/8 datë 01.11.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

**b. Për masa mungesë të ardhurash** janë rekomanduar 6 masa me vlerë 200,267 mijë lekë, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 6 masa, ku nga vlera e rekomanduar prej 200,267 mijë lekë është arkëtuar vlera 18,215 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 182,052 mijë lekë, konkretisht nuk janë zbatuar:

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej 5,300,000 lekë nga 3 subjektet, respektivisht;

- vlera 1,100,000 lekë nga subjekti “T.V.” ShPK
- vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “G.C.G.” ShPK;
- vlera 1,000,00, lekë nga subjekti “K.” ShPK;
- vlera 2,200,000 lekë nga subjekti “B.O.” ShPK

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 108,000 lekë, respektivisht:

- vlera 54,000 lekë, ndaj subjektit “N.”.
- vlera 54,000 lekë, ndaj subjekti “E. (A.G.)”.

## **B. Masa për shpërblim dëmi:**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike bashkia Finiq të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 561,540 lekë nga shoqëria “N.” shpk, për mos zbatim të kontratës nr. 1736, datë 4.7.2022.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve për menaxhimin e kontratave të analizojë dosjen e procedurës me objekt “Mirëmbajta e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës”, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 68, datë 19.4.2022 (mbi afatin e punimeve), dhe në rast të mungesës së dokumentacionit mbështetës të marrë masa në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Finiq duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 287,831 lekë nga subjekti “A.C.” shpk.

### **C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike**

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Finiq, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës ose me subjekte të licencuara për saktësinë e llogaritjes së fondit limit në përputhje me çmimet e manualit për të shmangur mos efektivitetin e fondeve të prokuruar për vlerën 2,290,080 lekë.

### **D. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për bashkërendimin e punës me të gjithë sektorët e tjerë të cilët funksionojnë në planifikimin e të ardhurave, duke përcaktuar qarte vlerat e të ardhurave që duhet planifikuar sipas burimit të krijimit të tyre. Në planifikim buxhetor për vazhdimësinë të pasqyrohen qarte vlera e debisë së mbartur si dhe detyrimi vjetor që është pasqyruar në regjistrin e të ardhurave. Gjithashtu nga ana e Drejtorisë të të ardhurave të Bashkisë të merren masat e menjëhershme për vlerësimin e detyrimeve të subjekteve që merren me tregtinë e hidrokarbureve, duke arkëtuar detyrimin prej 5,600,000 lekë, në rast të kundërt të vlerësohen kërkesat e ligjit deri në pezullimin e aktivitetit.

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Finiq, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën 213,212,631 lekë.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masat e menjëhershme për auditimin e statusit të këtyre subjekteve në teren, si dhe të kërkohet zbatimi i procedurave për përfitimin e këtij statusi. Po kështu të kërkohet menjëherë arkëtimi i detyrimeve të pa likuiduara nga ana e këtyre subjekteve që është në vlerën 1,757,602 lekë.

**3.1. Rekomandimi:** Njësia e Ujitjes dhe Kullimit pranë Bashkisë Finiq të bëjë monitorimin e gjithë sipërfaqes së mbjellë për çdo kulturë, të monitorojë kërkesat për vaditje dhe të vlerësojë detyrimin sipas kërkesave të ligjit nr. 24/2017, date 09/03/2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe të kullimit”.

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq në bashkëpunim me Njësinë e Ujitjes dhe Kullimit, të marrë masa të menjëhershme të bëjë njoftimin të gjithë fermerëve mbi detyrimet që kanë pa likuiduar për arkëtimin e detyrimeve të mbartura dhe të pa arkëtuar deri në fund të vitit 2022, për vlerën 3,465,443 lekë.

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës së detyrimit prej 3,548,500 lekë nga subjektet përkatës sipas trajtimit analitik të bërë në kapitullin e auditimit të kontratave të lidhura për dhënien me qira të sipërfaqeve kullosore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ankesave të z. F.S., administruar në KLSH me nr. 698 prot., datë 20.05.2024 dhe z. T.E., administruar në KLSH me nr. 730 prot., datë 29.05.2024, u krye verifikimi në Institucionin e Bashkisë Finiq, rezultoi si vijon:

Shtetasi N.V. për të cilin është bërë ankesa, ka ndërtuar një gardh me tela dhe shtylla të vogla të betonuara si dhe ka ndërtuar një portë metalike me dy fletë dhe me kolona të vogla betoni.



Për shkak të këtij rrethimi ka pasur ankesa nga banorë të fshatit të cilët pretendojnë se u është bllokuar rruga ekzistuese. Nga IMT dhe Policia Bashkiake Finiq, janë mbajtur disa akte/procesverbale ku janë pasqyruar situatat e konstatuara ndëtimore, si dhe është kërkuar dokumentacioni tekniko-ligjor nga kundërvajtësi. Nga dokumentacioni që administrohej në Bashkinë Finiq, përveç disa akteve/procesverbaleve të mbajtura, nuk disponohet asnjë dokumentacion për punimet e kryera, si dhe nuk disponohet dokumentacion për rrugën e cila është bllokuar. Nga IMT dhe Policia Bashkiake Finiq, pavarësisht mbajtjes së akteve ku konstatohet ndërtimi i gardhit dhe i portës së hekurit, rezulton se nuk janë nxjerrë akte të tjera administrative që lidhen me paligjshmërinë e situatës ndëtimore, duke mos pezulluar veprimet e kundërvajtësit, nxjerrjen e gjobës përkatëse dhe prishjen e ndërtimit.

Lidhur me arsimimin e K/inspektorit të Policisë Bashkiake, ai rezulton pa arsimin përkatës të nevojshëm për këtë pozicion pune.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, neni 5, geramat b, ç, d, Ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997, “Për policinë bashkiake”, neni 3, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, pika 5, 6 dhe 7.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 66-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit dhe Policia Bashkiake Finiq, të marrin masa për kontroll efektiv të territorit për ndërtimet e paligjshme dhe në çdo rast konstatimi, krahas pasqyrimit me procesverbalet dhe aktet administrative përkatëse, të nxirren edhe masat administrative sipas rastit. Të kërkohet dhe shqyrtohet dokumentacioni i pronës në të cilën kalonte rruga e vjetër, për të cilën pretendohet se është bllokuar.

Lidhur me arsimimin e K/inspektorit të Policisë Bashkiake, Kryetari i Bashkisë Finiq, duhet të ketë në konsideratë faktin se ky pozicion pune ka për detyrim arsimimin policor dhe të marrë masa për rekrutimin e stafit me kualifikimet e nevojshme.

*Në vijimësi*

## **B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARI FAT VENDOR E (TË ARDHURA TË MUNGUARA)**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifave vendore që kanë ndaj Bashkisë Finiq, u konstatua se deri në datën 31.12.2022, borxhi tatimor është 213,212,633 lekë. Gjatë vitit 2023 vlera debitore e krijuar është 68,982,140 lekë, në total 282,194,774 lekë, nga të cilat janë kontabilizuar 223,855,848 lekë. **Diferenca prej 58,338,926 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Finiq.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3. dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 27-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Finiq, Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, në vlerën totale **282,194,774 lekë.**

### **C. MASA DISIPLINORE**

Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Finiq**, fillimi ose jo i procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*” dhe Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Kreu IV, neni 11, shkronja “e” dhe “ç” dhe neni 37, bazuar në kontratën individuale të punës.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

### **KONTROLL I LARTË I SHTETIT**